

Haradinaj kërkon mbështetjen e ShBA-së për anëtarësim në Interpol

Kryeministri Ramush Haradinaj, gjatë takimit me zëvendësndihmësekretarin amerikan të Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco, ka kërkuar ndihmën e ShBA-së për anëtarësimin e Kosovës në Interpol ■ FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de



FLET PËR "EPOKËN E RE", BILALL SHERIFI ■ FAQE 4-5

Bashkëpunimi pozitiv-opozitiv për dialogun me Serbinë s'ka alternativë

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilal Sherifi, beson se pozita dhe opozita do ta arrijnë një konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se bashkëpunimi i pozitës me opozitën për

këtë çështje nuk ka alternativë. Sherifi ka treguar se Nisma nuk ka ndryshuar qëndrim për këtë çështje, duke insistuar në arritje të konsensusit. Sipas tij, vetëm krijimi i një ekipi të unitetit mes subjekteve politike do të ishte adekuat përballë sfidave që e presin Kosovën në

këtë fazë të fundit të dialogut. Sherifi ka theksuar se faza e konsultimeve mes partive politike ende nuk ka përfunduar, duke shprehur besimin në gjetjen e një formule të përbashkët pozitiv-opozitiv edhe për platformën dhe formatin e dialogut me Serbinë

AKTUALE

SHQYRTIMI DUHET TË ÇOJË NË ARGUMENTE TË REJA ■ 11

Hajdin ABAZI



HIQET LISTA E PRITJES ME STENTIME NË QKUK ■ 7

ARBEN VITIA ZGJEDHET KRYETAR I LËVIZJES VETËVENDOSJE NË PRISHTINË ■ 6

EKONOMI

LANSOHEM PROGRAMI PËR PËRKRAHJEN E IDEVE INOVATIVE TË TË BËRIT BIZNES ■ 8

VLERËSOHEN ARRITJET E KOSOVËS NË INDEKSIN PËR LIRITË EKONOMIKE ■ 8

KULTURË

ALBULENA BAJRAKTARI, 'MISS SOCIAL MEDIA', PO I RADHITË SUKSESET HAP PAS HAPI ■ 13

SPORT

DRITA SHKON NË SUEDI TË LË PËRSHTYPJE TË MIRË ■ 15

PREZANTOHET CR7: JAM GATI PËR JUVEN ■ 15

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) VAZHDON TË JETË JOFUNKSIONAL

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së, në dorë të Gjykatës Kushtetuese

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është duke pritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e

re" një burim brenda Presidencës. Sipas këtij burimi, Zyra e presidentit ka kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me numrin e nominimeve të subjekteve politike për anëtarë të KQZ-së, por deri më

tani nuk ka marrë përgjigje. Përderisa zyrtarët e partive në pushtet e shohin si të drejtë këtë veprim të presidentit, nga ana tjetër zyrtarët opozitarë e vlerësojnë si veprim për ta prolonguar procesin ■ FAQE 3



Liburn Aliu: Vendimi i Qeverisë për 53 milionët mund të anulohet ■ FAQE 5

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, nëpërmjet një konference për medie të hënën ka kërkuar sërish anulimin e

vendimit të Qeverisë për dhënien e 53 milionë eurove shtesë kompanisë "Betchel Enka" për autostradën "Arbën Xhaferi"



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Komisari Hahn në Tiranë dhe Shkup nis procesin e 'skriningut'

Komisari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, sot (e martë) do të arrijë në Tiranë dhe Shkup për ta hapur zyrtarisht punën përgatitore apo, siç njihet, procesi "skrining" pas vendimit të Këshillit që vendosi rrugën e hapjes së negociatave për anëtarësim në qershor të 2019-s, me Maqedoninë dhe Shqipërinë



SHKUP, 16 KORRIK - Komisar i Evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn, ashtu siç dhe bëri të ditur në samitin e Londrës, sot (e martë) do ta nisë vizitën zyrtare në Shkup dhe Tiranë. Vizita vjen pas vendimit të Këshillit që vendosi rrugën e hapjes në negociatave për anëtarësim në qershor të 2019-s, me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Sipas njoftimit zyrtar në faqen e Hahnit, eurokomisionari do ta çelë zyrtarisht punën përgatitore apo, siç dhe njihet, procesi "screening". Agjenda e publikuar bën të ditur se në Tiranë eurokomisionari Hahn do të takohet me presidentin Ilir Meta, kryeministrin Edi Rama dhe përfaqësues të Qeverisë së Shqipërisë, por jo me krerë të partive politike siç do të bëjë në Shkup, duke mos pasur një takim me kreun e PD-së, Lulzim Basha. Zyrtari i lartë i Brukselit dhe krerët e politikës shqiptare do të diskutojnë për integrimin e hapat që duhen ndërmarrë për fazën përgatitore për hapjen e negociatave vitin e ardhshëm. Gjatë samitit të Brukselit, Hahn bëri të qartë se Shqipëria do ta vijojë zbatimin e reformave dhe me plotësimin e pesë prioritetve për të marrë përgjigje pozi-

tive.

Pas vizitës në Tiranë, Hahn do të udhëtojë për në Maqedoni.

Johanes Han në Shkup sot (e martë) në mëngjes do të takohet me kryeministrin Zoran Zaev dhe më pas edhe me kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferi dhe me liderin e partisë opozitare VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski. Komisar i Hahn do të mbajë fjalim para anëtarëve të Këshillit kombëtar për eurointegrim në Kuvend.

Javën e kaluar Hahn në konferencë me gazetarë në Bruksel i paralajmëroi vizitat në Maqedoni dhe në Shqipëri dhe fillimin e procesit të skriningut në këto dy vende. Eurokomisari pas përfundimit të takimeve në Shkup, sot (e martë) pasdite do të udhëtojë për në Tiranë.

Kryeministri Zoran Zaev të premten në takim me përfaqësuesit e organizatave civile deklaroi se me ardhjen e Hahnit në Shkup fillon procesi i skriningut. "Qëllimi është që në sesion qeveritar t'i hapim proceset dhe kjo do të thotë që sa më parë duhet ta përgatisim shtetin edhe me kornizë negociuese, edhe me ekipet negociuese për procesin për të

cilin është shumë me rëndësi sa kohë do të humbasim", tha Zaevi. Ai shtoi se nga 33 kapitujt për Maqedoninë, do të duhet të ketë edhe 33 grupe të punës në të cilët do të duhet të përfshihen përfaqësuesit edhe nga institucionet dhe nga shoqëria civile.

Lidhur me referendumin, Zaevi edhe një herë shprehu bindje se ai do të jetë i suksesshëm dhe se këtë javë do të saktësohen çështjet rreth asaj se kur do të jetë referendumi, nëse ai do të jetë obligues ose konsultativ dhe si do të formulohet çështja e referendumit. Në fund kryeministri Zoran Zaev paralajmëroi se do të kërkojë që opozita dhe të gjithë faktorët politikë t'i pastrojnë pozitën e tyre në pjesën e referendumit. Muajin e kaluar vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhanë leje të kushtëzuar për Maqedoninë dhe Shqipërinë për t'i hapur negociatat e anëtarësimit. Ato u pajtuan që dy vendet, në qershor të vitit 2019, ta nisin procesin drejt hapjes së negociatave, por me kusht që ato të dëshmojnë përparim në reforma, përpara se të nisin negociatat e vërteta në fund të vitit 2019.

LAJME SHKURT



Baily: Ivanovi është për Maqedoninë në NATO

SHKUP, 16 KORRIK - Ambasadori i ShBA-së në Shkup, Jess Baily, tha se kryetari Gjorge Ivanov është për anëtarësimin e vendit në NATO. Sipas sugjerimit që Ivanovi na ka përgëzuar për ftesën nga Aleanca dhe se gjatë asaj kohe ai ishte në inaugurimin e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, diplomati komentoi se ishte i bindur për qëndrimin pozitiv të shefit të shtetit ndaj NATO-s. "Kryetari Ivanov ka shprehur prej kohësh mbështetjen e tij për të ardhmen e Maqedonisë në NATO dhe BE, duke përfshirë edhe në diskutimet me mua. Unë shpresoj se ai do ta mbështesë avancimin e procesit. Ai shprehu shqetësimin e tij në lidhje me marrëveshjen e Prespës, por Kuvendi dy herë votoi për ratifikim", tha Baily. "Së shpejti qytetarët e Maqedonisë do ta kenë mundësinë për ta shprehur qëndrimin e tyre. Përsëri, marrëveshja me Greqinë përfshin kompromise të vështirë, por në ndërkohë është edhe një mundësi historike për ta siguruar të ardhmen e vendit në familjen e demokracive perëndimore, NATO-s dhe BE-së, me emrin e ri 'Republika e Maqedonisë Veriore'", tha ambasadori Baily.



Zaevi: Biznesmenë pro rusë paguajnë për ta penguar anëtarësimin në NATO

SHKUP, 17 KORRIK - Kryeministri Zoran Zaev ka deklaruar se ka informata për biznesmenë pro rusë të cilët tentojnë ta pengojnë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, duke krijuar protesta të dhunshme. "Shtetas të huaj, të afërt me Rusinë, kanë paguar mijëra dollarë që të shkaktojnë dhunë me qëllim që ta pengojnë integrimin e Maqedonisë në NATO", deklaroi Zaevi. "Një pjesë e tyre janë të lidhur me media, një pjesë i nxisin të rinjtë të protestojnë përpara Kuvendit dhe ta sulmojnë policinë. Ajo shihet qartë", shtoi Zaevi. Ai refuzoi të tregojë se kush qëndron prapa pagesave, duke theksuar se ka një hetim për të njëjtën dhe se bëhet fjalë për marrëdhënie të ndjeshme diplomatike. Ai ka theksuar se policia ka mësuar për pagesat pas arrestimit të disa pjesëmarrësve në protestat e dhunshme përpara Kuvendit në muajin e kaluar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdon të jetë jofunksional

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së, në dorë të Gjykatës Kushtetuese

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është duke pritur vendimin e Gjykatës Kushtetuese për emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" një burim brenda Presidencës. Sipas këtij burimi, Zyra e presidentit ka kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me numrin e nominimeve të subjekteve politike për anëtarë të KQZ-së, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Përdërisa zyrtarët e partive në pushtet e shohin si të drejtë këtë veprim të presidentit, nga ana tjetër zyrtarët opozitarë e vlerësojnë si veprim për ta prolonguar procesin

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 16 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, javë më parë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për ta marrë mendimin e saj lidhur me numrin e nominimeve të subjekteve politike për anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Burime të gazetës "Epoka e re" brenda Presidencës kanë bërë me dije të hënën se deri më tani Gjykata Kushtetuese nuk ka kthyer përgjigje për shkak të mosdekremit të gjyqtarëve të rinj. "Kemi kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën e subjekteve politike/grupeve parlamentare për nominimin e anëtarëve të KQZ-së. Jemi në pritje të vendimit të gjykatës dhe në momentin që ta marrim përgjigjen do të vazhdojë procesi i emërimit të anëtarëve të rinj të KQZ-së", ka thënë ky burim. Përdërisa zyrtarët e partive në pushtet e shohin si të drejtë veprimin e presidentit për ta marrë opinionin e Kushtetueses, nga ana

tjetër zyrtarët opozitarë e vlerësojnë si veprim për ta prolonguar procesin. Një zyrtar i koalicionit qeveritar i ka thënë gazetës në kushte anonimiteti, se është në të mirën e procesit kërkitimi i mendimit të opinionit të Gjykatës Kushtetuese. "Për t'i hequr të gjitha dilemat e subjekteve politike, Presidencia i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të marrë mendim lidhur me të drejtën e grupeve parlamentare për nominimin e anëtarëve të rinj të KQZ-së. Prandaj këtu nuk ka kurrfarë prolongimi të procesit", është shprehur ky zyrtar. Por, për dallim prej pushtetit, opozitarët e shohin si të qëllimshëm kërkesën e presidentit Thaçi në drejtim të Kushtetueses. Një përfaqësues i opozitës në kushte anonimiteti i ka thënë gazetës se presidenti po e favorizon koalicionin qeverisës. "Presidencia i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese vetëm për ta prolonguar procesin. Nuk ka pasur nevojë të pyetet Gjykata Kushtetuese sepse është e qartë se nga sa anëtarë u takojnë subjekteve

politike. Qëllimisht është dërguar çështja në gjykatë e cila asokohe ka qenë jofunksionale. Tani janë zgjedhur gjyqtarët, por ende nuk janë dekretuar dhe derisa të ndodhë dekretimi do të marrë kohë. Thjesht është bërë për t'u prolonguar, eventualisht për të zgjidhur me këtë përbërje sipas së cilës koalicioni aktual i ka katër përfaqësues dhe dy opozita. Ndërsa sipas përbërjes së re, bazuar në rezultatin e zgjedhjeve, opozitës i bëhen katër përfaqësues, kurse koalicionit aktual dy", ka thënë ky zyrtar.

Për procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të KQZ-së ka folur të hënën për gazetën "Epoka e re" njohësi i proceseve politike dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu. Ai i ka quajtur të panevojshme vonesat e deritanishme në këtë proces. "Nuk ka pasur nevojë të prolongohet emërimi i anëtarëve të KQZ-së por, sikur herëve të tjera, edhe në institucione të tjera, edhe në KQZ nuk ka pasur përpikëri në

zbatimin e dispozitave ligjore dhe afateve ligjore për sa i përket caktimit të anëtarëve të KQZ-së, përkatësisht propozimit nga subjektet politike, pastaj emërimit nga Presidencia. Edhe këtë herë është neglizhuar puna dhe janë shtyrë afatet. Në ndërkohë kanë ndodhur ndryshime në skenën politike, pra nga Lëvizja Vetëvendosje është formuar një grup i ri parlamentar, edhe te grupet e tjera parlamentare ka pasur disa ndryshime, pra ka pasur lëvizje të deputetëve nga një grup parlamentar në një grup tjetër. Kurse mandati u ka kaluar anëtarëve dhe është bërë jofunksional KQZ-ja. Ani pse KQZ-ja në vazhdimësi duhet të jetë funksionale dhe aktive ajo nuk ka ndodhur. Tani është jofunksionale dhe nuk mund të marrë asnjë vendim", ka deklaruar Baraliu, duke shtuar se Gjykata Kushtetuese sa më shpejt duhet ta japë mendimin e vet lidhur me çështjen e emërimit të anëtarëve të KQZ-

së. "Gjykata Kushtetuese do të duhej të vepronte shumë shpejt dhe me prioritet në këtë çështje, por nuk ka vepruar dhe kemi një gjendje amorfe politike sa iu përket mandateve kushtetuese të anëtarëve të KQZ-së. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme parashih se nga sa anëtarë mund t'i dërgojnë subjektet politike. Por, tash janë krijuar situata politike amorfe dhe të palogjikshme me mosrespektimin e afateve ligjore dhe jemi në një situatë kur Kushtetuesja duhet të vendosë. Nuk do të duhej të ndodhin vonesa të paarsyeshme për emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Të gjithë janë vonuar në këtë proces", ka theksuar Baraliu. Ndërkohë në pritje të emërimit nga presidenti Hashim Thaçi për anëtarë të KQZ-së është Ilir Gashi nga PDK-ja, Binak Vishaj nga Aleanca dhe Nisma Socialdemokrate, Sami Hamiti e Florian Dushi nga LDK-ja si dhe Adnan Rrustemi e Nazlie Bala nga Vetëvendosja.

Kapiteni i FSK-së varroset me nderime ushtarake

PRIZREN, 16 KORRIK (ER) - Në Landovicë të Prizrenit është varrosur me nderime të larta ushtarake kapiten Sejdi Krasniqi, i cili ishte komandant i Njësisë së Çminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së. Sejdi Krasniqi ka ndërruar jetë të dielën pas një sëmundje të rëndë. Për t'i dhënë lamtumirën e fundit kapiten Sejdi Krasniqi nga Ministria e FSK-së kanë qenë të pranishëm sekretari i përgjithshëm i kësaj ministrie, Shkëlzen Sylaj, komandanti i Komandës së Forcës Tokësore (KFT), gjeneralbrigade Enver

Cikaqi, drejtori i Operacioneve, gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, shefi i operacioneve dhe trajnimeve, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj, zëvendëskomandanti i KFT-së, gjeneralbrigade Naim Haziraj, komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, Xhevahir Geci si dhe oficerë dhe zyrtarë të lartë të FSK-së dhe të MFSK-së. Po të hënën është mbajtur edhe një akademi përkujtimore kushtuar komandantit të Njësisë së Çminimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK-së, Sejdi Krasniqi.



FLET PËR 'EPOKËN E RE', BILALL SHERIFI

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, beson se pozita dhe opozita do ta arrijnë një konsensus për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se bashkëpunimi i pozitës me opozitën për këtë çështje nuk ka alternativë. Sherifi ka treguar se Nisma nuk ka ndryshuar qëndrim për këtë çështje, duke insistuar në arritje të konsensusit. Sipas tij, vetëm krijimi i një ekipi të unitetit mes subjekteve politike do të ishte adekuat përballë sfidave që e presin Kosovën në këtë fazë të fundit të dialogut. Sherifi ka theksuar se faza e konsultimeve mes partive politike ende nuk ka përfunduar, duke shprehur besimin në gjetjen e një formule të përbashkët pozitë-opozitë edhe për platformën dhe formatin e dialogut me Serbinë

Bashkëpunimi pozitë-opozitë për dialogun me Serbinë s'ka alternativë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka bërë me dije se bashkëpunimi i pozitës dhe opozitës për fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë nuk ka alternativë. Ai ka thënë se hyrja në këtë proces pa një unitet të brendshëm do t'i dëmtonte rëndë interesat afatgjata të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Sherifi ka vlerësuar se vetëm krijimi i një ekipi të unitetit në mes të pozitës dhe opozitës do të ishte adekuat përballë sfidave që e presin Kosovën në këtë fazë të fundit të dialogut. "Bashkëpunimi i pozitës dhe opozitës nuk ka alternativë. Dialogu me Serbinë nuk është çështje e një legjislature, as edhe

e një qeverie, por ka të bëjë me fatin e vendit tonë në dekadat e ardhshme. Prandaj futja në një proces të tillë pa një unitet të brendshëm do t'i dëmtonte rëndë interesat afatgjata të Kosovës. Vetëm një ekip i unitetit pozitë-opozitë do të ishte adekuat përballë sfidave që e presin Kosovën në këtë fazë të fundit të dialogut", ka thënë Sherifi. Ai ka treguar se faza e konsultimeve mes partive politike ende nuk ka përfunduar, duke shtuar se ende beson se do të arrihet të gjendet një formulë e përbashkët pozitë-opozitë për platformën dhe për formatin e procesit. Sherifi ka deklaruar se Nisma insiston në ndërtim të platformës së përbashkët për dialog dhe një përfshirje sa më të gjerë të forcave politike në këtë proces. "Nuk kemi ndryshuar qëndrim. Ne vazhdojmë të insistojmë në



ndërtim të platformës së përbashkët për dialog dhe një përfshirje sa më të gjerë të forcave politike në këtë proces. Çdo rrugë tjetër është e gabuar dhe, si e tillë, nuk do të mbështetet nga Nisma Socialdemokrate!", është shprehur ai.

Më tej, Sherifi ka treguar edhe në takimin e kësaj të mërkure liderët shtetërorë do ta informojnë Mogherinin për përpjekjet rreth arritjes së konsensusit për këtë çështje. "Arsyeja tjetër e takimit ka të bëjë edhe me fazën e fundit të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Zonja Mogherini do të njoftohet me përpjekjet që janë duke u bërë nga ana e Kosovës për harmonizim të platformës dhe për formatin në fazën e fundit të dialogut. Prandaj mund të them se ende nuk ka përfunduar harmonizimi as për platformën e as për formatin, as brenda koalicionit dhe as me partitë opozitare.

formatin, as brenda koalicionit dhe as me partitë opozitare", ka thënë Sherifi.

"Epoka e re": Z. Sherifi, udhëheqësit e institucioneve të Kosovës të mërkurën do ta takojnë përfaqësuesen e lartë të BE-së, Frederica Mogherini, në Bruksel, lidhur me çështjen e dialogut me Serbinë dhe disa çështje të tjera. A ka qëndrim unik koalicioni qeverisës për këtë çështje?

Sherifi: Më lejoni së pari të sqaroj një gjë. Kosova nuk e ka asnjë arsye të vetme që të mos shkojë në takime ndërkombëtare kurdo dhe nga kushdo që ajo ftohet. Shkuarjen në Bruksel me ftesë të Mogherinit e shoh nga ky këndvështrim. Takimi i të mërkurës ka për qëllim që përmes znj. Mogherini të informohet BE-ja se Kosova i ka kryer të gjitha detyrimet e veta sa i përket liber-

alizimit të vizave dhe tani me të drejtë pret që BE-ja të veprojë konform premtimeve që i ka dhënë gjatë këtyre viteve. Pra, BE-ja është para alternativës: Ose ta caktojë datën për liberalizim të vizave ose t'i tregojë arsyet e vërteta të shtyrjes së vendimit për liberalizim të vizave. Arsyeja tjetër e takimit ka të bëjë edhe me fazën e fundit të bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Znj. Mogherini do të njoftohet me përpjekjet që janë duke u bërë nga ana e Kosovës për harmonizim të platformës dhe për formatin në fazën e fundit të dialogut. Prandaj mund të them se ende nuk ka përfunduar harmonizimi as për platformën e as për formatin, as brenda koalicionit dhe as me partitë opozitare.

"Epoka e re": Deri më tani Nisma Socialdemokrate për fazën përfundimtare të dialogut ka pasur një qëndrim pak më ndryshe se subjektet e tjera të koalicionit. Cili pritet të jetë qëndrimi përfundimtar i këtij subjekti politik?

Sherifi: Nuk kemi ndryshuar qëndrim. Ne vazhdojmë të insistojmë në ndërtim të platformës së përbashkët për dialog dhe një përfshirje sa më të gjerë të forcave politike në këtë proces. Çdo rrugë tjetër është e gabuar dhe, si e tillë, nuk do të mbështetet nga Nisma Socialdemokrate.

"Epoka e re": Si duhet të jetë përfaqësimi i Kosovës në këtë fazë të dialogut. Është përmendur edhe formati i ekipit të unitetit?

Sherifi: Sikur që thashë më parë, bashkëpunimi i pozitës dhe opozitës nuk ka alternativë. Dialogu me Serbinë nuk është çështje e një legjislature as edhe e një qeverie, por ka të bëjë me fatin e vendit tonë në dekadat e ardhshme. Prandaj futja në një proces të tillë, pa një unitet të brendshëm, do t'i dëmtonte rëndë interesat afatgjatë të Kosovës. Vetëm një ekip i unitetit pozitë-opozitë do të ishte adekuat përballë sfidave që e presin Kosovën në këtë fazë të fundit të dialogut.

"Epoka e re": Cili do të duhej të ishte roli Kuvendit të Kosovës në këtë fazë të dialogut?

Sherifi: Roli i Kuvendit është ai që ia garanton edhe Kushtetuta jonë, ratifikues i marrëveshjeve. Mirëpo për shkak të rëndësisë që ka dialogu me Serbinë, mendoj se Kuvendi i Kosovës duhet të përfshihet në mënyrë të drejtë për drejtë dhe shumë aktive.

"Epoka e re": Deri më tani opozita ka refuzuar pjesëmarrjen në këtë proces. Mospjesëmarrja e ndonjë subjekti opozitar në fazën finale mund ta zbehë procesin dialogues?

Sherifi: Faza e konsultimeve mes partive politike ende nuk ka përfunduar, prandaj ende besoj se do të arrijmë të gjejmë një formulë të përbashkët pozitë-opozitë edhe për platformën, edhe për formatin.

Aliu: Vendimi i Qeverisë për 53 milionët mund të anulohet

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka kërkuar sërish anulimin e vendimit të Qeverisë për dhënien e 53 milionë eurove shtesë kompanisë "Betchel Enka" për autostradën "Arben Xhaferi". Ai ka treguar se në bazë të disa informacioneve marrëveshja për dhënien e këtyre mjeteve ende nuk është nënshkruar dhe, sipas tij, kjo tregon se vendimi mund të anulohet

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka folur të hënën për rezolutën e propozuar në Kuvendin e Kosovës e cila do ta parandalonte humbjen e paarsyeshme të 53 milionë eurove për konsorciumin "Bechtel Enka". Në një konferencë për media, Aliu ka theksuar se rezoluta e cila nuk është përkrahur në Kuvend kërkonte anulimin e vendimit të Qeverisë për aprovimin e kërkesës të konsorciumit "Bechtel Enka". Sipas tij, kërkesat e rezolutës ishin tejet të qarta, duke shtuar se ato lidheshin me transparencën, parandalimin e dëmit që i shkaktohet buxhetit të Kosovës, si dhe me korrigjimin e shkeljeve ligjore. "Kjo rezolutë për bindjen tonë ishte një shans i mirë për Qeverinë Haradinaj që ta hiqte nga vetja barrën e shkeljes, duke marrë një vendim të kundërligjshëm. Madje gjatë debatit kryeministri Haradinaj deklaroi se Kuvendi duhet ta marrë përgjegjësinë dhe të anulohet vendimi. Deputetët e subjektit të të cilit ai është kryetar votuan kundër", ka deklaruar Aliu.

Ai ka thënë se me 53 milionë euro mund të bëheshin ndryshime në sistemin e shën-

detësisë apo të arsimit në Kosovë. Sipas Aliut, me një përlogaritjeje të thjeshtë mund të ndërtoheshin 20 çerdhe, 10 shkolla fillore, 5 shkolla të mesme dhe 5 qendra të mjekësisë familjare. Ai ka bërë me dije se në bazë të informacionit që qarkullonte në Kuvend në ditën e votimit të rezolutës, ende nuk është lidhur ndonjë kontratë në lidhje me vendimin e Qeverisë. Sipas tij, ka ende kohë të parandalohet shkelja dhe dëmi duke u anuluar ky vendim. "Ne kërkojmë nga organet e drejtësisë që ta marrin situatën në dorë, ta hetojnë dhe ta parandalojnë procedimin e mëtejshëm të vendimit, duke e anuluar atë dhe duke pamundësuar kontratën mbi atë vendim. Në rast se është nënshkruar dhe realizuar tanimë kontratë e bazuar në këtë vendim të jashtëligjshëm të Qeverisë, atëherë organet e drejtësisë duhet të veprojnë drejt hetimit dhe sjelljes para drejtësisë të fajtorëve. Shteti nuk bën të qëndrojnë symbyllur para kësaj shkeljeje. Prandaj organet shtetërore duhet ta parandalojnë dëmin dhe ato para të shkojnë në destinacione të tjera që Kosova ka aq shumë nevojë", ka deklaruar Aliu.



Avokati i Popullit kërkon të hiqet mosha e fëmijëve për ata që marrin ndihma sociale

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Avokati i Popullit ia ka përcjellë Kuvendit të Kosovës raportin me rekomandime përkitazi mbi ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/1-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë. "Qëllimi i këtij raporti është t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4, të Ligjit i cili kushtëzon ndarjen e ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç. Raporti, gjithashtu, arsyeton domosdoshmërinë e ndryshimit të nenit 4 të Ligjit në raport me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pasi me këtë kufizim po rëndohet edhe më shumë jeta dhe mirëqenia e qytetarëve të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike", është thënë në komunikatën e këtij institu-

cioni.

Avokati i Popullit ka vërejtur se zbatimi i nenit 4 të Ligjit ka shkaktuar që shumë familje në gjendje të rëndë materiale, të mbesin edhe pa ndihmën sociale, të cilën e gëzonin deri në çastin kur fëmija mbush pesë (5) vjeç. "Pavarësisht se janë bërë ndryshime të nenit 4 të Ligjit nr. 2003/15, kjo nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfra me vetë faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale, me dispozitat ligjore në fuqi kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi, veçmas qytetarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian", është thënë në komunikatën e Avokatit të Popullit.

Ky institucion ka vlerësuar se neni 4 i Ligjit, përtej çdo dyshimi, shkel interesin më të mirë të fëmijës. "Madje mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe

familje në nevojë, kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës, si dhe në edukimin e zhvillimin e mëtutjeshëm të tij. Avokati i Popullit, në pajtim me gjetjet e theksuara në raport, konstaton se neni 4 i Ligjit është në kundërshtim me Kushtetutën Republikës së Kosovës, standardet ndërkombëtare, veçmas Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Në bazë të analizës, vlerësimeve dhe konstatimeve, Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës Ndryshimin e nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/1-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës pesë (5) vjeç të fëmijës, të ngrihet në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, në pajtim me nocionin e termit 'fëmijë' dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve kushtetuese", është thënë në komunikatën e Avokatit të Popullit.

**Republika e Kosovës****Avokati i Popullit**

Bashkëpunimi në fushën e arsimit me shtetin gjerman, i nevojshëm për Kosovën

**EPOKA
ERE****Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 16 KORRIK - "Shkëmbimi i nxënësve, studentëve dhe mësimdhënësve me institucionet e njohura gjermane është veprim i duhur dhe Qeveria e Kosovës mbështet nisma të tilla që kanë për qëllim ngritjen e nivelit të arsimit në vend", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj, pasi priti në takim Kerstin Zielosko-Labonte, zyrtare e Lartë nga Ministria e Kulturës dhe Sportit nga Baden Württemberg i Gjermanisë dhe koordinatorë e projekteve në fushën e arsimit, Gjermani - Kosovë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj e ka falënderuar Gjermaninë për mbështetjen e gjithanshme që i ka dhënë Kosovës në shtetndërtim, veçmas në fushën e arsimit përmes memorandumeve të bashkëpunimit ndërmjet dyja vendeve, memorandume këto që kanë dhënë rezultate në këmbimin e përvojave dhe njohurive të shumë nxënësve, studentëve dhe mësimdhënësve nga shumë komuna të Kosovës. "Nxënësi i Kosovës është



edhe i Gjermanisë, është nxënës evropian. Ky është orientimi ynë dhe çdo nismë për të fuqizuar këtë do të përkrahet nga Qeveria e vendit", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke e falënderuar Labonte për marrëveshjet e deritashme dhe duke e inkurajuar që të ndodhin edhe të tjera, si ajo mes Education Unlimited dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar nevojën e mëtutjeshme për mbështetjen e Gjermanisë në arsim, shkëmbimin e përvojave, në ngritjen e shkollave profesionale, në

mënyrë që nxënësit të jenë të përgatitur për tregun e punës dhe fusha të tjera që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit në Kosovë. Ndërkaq Kerstin Zielosko-Labonte, zyrtare e Lartë nga Ministria e Kulturës dhe Sportit e Baden Württemberg, ka vlerësuar progresin në Kosovë, duke ofruar mbështetjen e mëtutjeshme për Kosovën, me theks në fushën e arsimit, trajnimin e nxënësve, studentëve dhe mësuesve në programe specifike, organizmin e kampingeve verore për nxënësit dhe të rinjtë në disa komuna të Kosovës.

Arben Vitia zgjedhet kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Arben Vitia është zgjedhur kryetar i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë. "Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë ka mbajtur zgjedhjet e brendshme për kryetar të Qendrës. Në një proces zgjedhor demokratik e gjithëpërfshirës, me njëzetegjashtë vendvotime të hapura gjithandej Komunes së Prishtinës, ku të gjithë anëtarët e Lëvizjes nga Komuna e Prishtinës kanë pasur të drejtën dhe mundësinë që përmes parimit 'Një anëtarë një votë' ta shprehin vullnetin e tyre për kryetarin e ardhshëm të Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë. Pas përfundimit të votimit dhe numërimit të votave, KZAQ-ja, qendra në Prishtinë, njofton të gjithë anëtarët e Lëvizjes dhe mbështetësit e saj, se kandidati Arben Vitia është zgjedhur kryetar i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka falënderuar të gjithë aktivistët për pjesëmarrje në



votime. "Ky proces zgjedhor dëshmoi edhe një herë demokracinë e pashembullt në organizatën tonë, rolin dhe rëndësinë që ka aktivisti, sikurse që shfaqti entuziazmin e lartë në mesin e anëtarëve për zgjerimin dhe rritjen e Lëvizjes Vetëvendosje edhe në Prishtinë si kudo në Kosovë. KZAQ-ja vlerëson lart mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, në të cilin u arritën standarde të reja të proceseve zgjedhore brenda organizatës. Falënderojmë të gjithë anëtarët e aktivistët për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre", është bërë me dije në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur në takim zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco

Haradinaj kërkon mbështetjen e ShBA-së për anëtarësim në Interpol

Kryeministri Ramush Haradinaj, gjatë takimit me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco, ka kërkuar ndihmën e ShBA-së për anëtarësimin e Kosovës në Interpol. Haradinaj me zyrtarin e lartë amerikan ka biseduar të hënën edhe për liberalizimin e vizave, finalizimin e dialogut me Serbinë dhe anëtarësimin e Kosovës në BE dhe NATO

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 KORRIK - "Mbështetja e ShBA-së në proceset nëpër të cilat po kalon vendi, liberalizimin e vizave, finalizimin e dialogut me Serbinë dhe anëtarësimin në BE dhe NATO, është jetike për Kosovën dhe qytetarët e saj", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj të hënën gjatë takimit me zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco. Në këtë takim, ku i pranishëm ishte edhe ambasadori amerikan Greg Delawie, kryeministri Haradinaj e ka njoftuar zëvendësndihmëssekretarin Marocco për të arriturat në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit, zhvillimin ekonomik, parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit ekstrem, duke theksuar përkushtimin e Qeverisë për paqen e qëndrueshme në vend dhe rajon. "Kosova ka dëshmuar përkushtimin e saj që të parandalojë dhe luftojë ekstremizmin në vend dhe ky angazhim do të vazhdojë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke konfirmuar vizionin

euroatlantik të Kosovës.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se anëtarësimi në Interpol do ta ndihmonte jo vetëm Kosovën, por edhe rajonin dhe BE-në për fuqizimin e sigurisë dhe se për këtë është e nevojshme edhe ndihma e ShBA-së.

Haradinaj e ka falënderuar zëvendësndihmëssekretarin Marocco për ndihmën e vazhdueshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhënë Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit. Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco, ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke theksuar përkushtimin e ShBA-së për ta ndihmuar Kosovën në të gjitha proceset e rëndësishme për vendin, derisa ka çmuar angazhimin konkret të Kosovës në luftimin e ekstremizmit dhe terrorizmit.

Edhe ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka pritur në takim zëvendësndihmëssekretarin amerikan të Shtetit për Çështjen e Parandalimit të Konfliktëve, Pete Marocco. Në këtë takim u bisedua lidhur me çështjen e sigurisë dhe proceset nëpër të cilat po kalon Republika e

Kosovës.

Gjatë këtij takimi Gashi e ka njoftuar Maroccon lidhur me punën e institucioneve të sigurisë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në vend. "Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj të sigurisë do të vazhdojnë t'i luftojnë aktivitetet e jashtëligjshme në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin në Republikën e

Kosovës", ka thënë ministri Gashi, i cili ka theksuar se Ministria e Punëve të Brendshme është e përkushtuar në luftimin e të gjitha llojeve të krimit të organizuar, duke përfshirë këtu edhe krimin trans-kufitar.

Në këtë drejtim, ministri i brendshëm vlerësoi se anëtarësimi në Interpol tashmë është një domosdoshmëri për ofrimin e sigurisë jo vetëm në

Republikën e Kosovës, por edhe në rajon e më gjerë. Në anën tjetër, zyrtari amerikan ka vlerësuar të arriturat në Kosovë, duke pohuar se është e nevojshme për një përkushtim më të madh në ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të sigurisë në Kosovë. Me këtë rast, ai u zotua se përkrahja e ShBA-së në forcimin e mëtejme të institucioneve të sigurisë në Kosovë do të vazhdojë edhe më tutje.



Hiqet lista e pritjes me stentime në QKUK

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Pas punës intensive 24 orëshe, 7 ditë në javë në Shërbimin e Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), është arritur që në tërësi të hiqet lista e pritjes së pacientëve për stentim. "Tani pacientët që kanë nevojë për stentim, stentohen menjëherë si raste urgjente, ose caktohet data e saktë e procedurës, nëse rasti nuk është emergjent", është bërë me dije

në njoftimin e QKUK-së. Shërbimi i Kardiologjisë Invazive nga janari i vitit 2018 ka shënuar rezultate të theksuara, duke realizuar 1 265 angiografi koronare, si dhe 710 intervenime (PCI, procedura me stentim). Në javën e kaluar janë realizuar dy intervenime kardiokirurgjike për shkak të diseksionit akut (qarje a murit të aortës). Dy pacientët tani janë në transferuar nga Njësia Intenzive në repart dhe janë stabilë.

Lansohet programi për përkrahjen e ideve inovative të të bërit biznes



Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka lansuar të hënën Programin për mbështetjen financiare të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për Bizneset Fillestare "Start-up" dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM). Me këtë rast, ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka theksuar se sektorët me prioritet që do t'i mbështesin do të jenë teknologjia informative, edukimi, energjia, shëndetësia, infrastruktura, prodhimi dhe shërbimet

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka lansuar të hënën Programin për mbështetjen financiare të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për Bizneset Fillestare "Start-up" dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM). Në ceremoninë e lansimit të këtij programi kanë marrë pjesë ministri i

Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ministri i Financave, Bedri Hamza, deputetë, përfaqësues të bizneseve dhe inovatorë të rinj. Në fjalën e tij para të pranishmëve ministri Besim Beqaj ka folur për rëndësinë e lansimit të këtij programi i cili ka për qëllim mbështetjen financiare të NVM-ve dhe "Start-upeve". "Ky program financiar që sot po lansojmë ka për synim t'i përkrahë

idetë inovative të të bërit biznes, bazuar në njohuri dhe shkathhtësi të buta, ekonomi të bazuar në dije dhe teknologji. Sektorët me prioritet që do t'i mbështesin janë teknologjia informative, edukimi, energjia, shëndetësia, infrastruktura, prodhimi dhe shërbimet", ka bërë me dije ministri Beqaj. Ministri Besim Beqaj ka saktësuar se ky program do të jetë i strukturuar në tri nivele financi-

mi: niveli i parë i financimit deri në 20 000 euro, niveli i dytë i financimit deri në 50 000 euro dhe niveli i tretë i financimit deri në 100 000 euro. Ndërsa ministri i Financave, Bedri Hamza, ka folur për rëndësinë e fuqizimit të sektorit privat. Ai ka thënë se fuqizimi i këtij sektori krijon vende të reja pune. "Përparësitë të Kosovës janë gjenerata e re, njerëz të përgatitur, sidomos në fushën e IT-së, që ka bërë që Kosova të eksportojë shërbime dhe produkte të teknologjisë informative", ka deklaruar Hamza. Ministri Hamza ka thënë se kontribuesi më i madh në Kosovë është sektori privat prandaj, sipas tij, Qeveria ka obligim të sigurojë kushte për këtë sektor.

Në këtë ngjarje, për rëndësinë e përkrahjes së NVM-ve dhe "Start-upeve", ka folur edhe Artë Shehu-Zaimi nga Akademia "Jcoders", e cila ka theksuar se përkrahja financiare për idetë inovative dhe "Start-upet" ka munguar, ndërsa përkrahja që do të vijë nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të mundësojë zhvillim të këtij sektori që ka potencial të jashtëzakonshëm. "Skema e granteve që po shpalojnë sot këtu është mundësi e cila mund të na fuqizojë në misionet tona dhe e mirëpresim si komunitet i Start-upeve". Ka thënë Shehu-Zaimi, duke shtuar se lansimi i sotëm i këtij programi është zëri i dëgjuar i komunitetit të "Start-upeve" në Kosovë.



Zona Ekonomike në Vushtrri hap vende të reja pune

VUSHTRRI, 16 KORRIK (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, dhe kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, kanë nënshkruar të hënën marrëveshjen për zonën ekonomike në këtë komunë. Me këtë marrëveshje do të nisin investimet rreth 1.5 milion euro në Zonën Ekonomike në Vushtrri, gjegjësisht në Lumë të Madh. "Me krijimin e kësaj zone synojmë që bizneseve të Vushtrrisë t'u krijo-

jmë kushte më të mira për punë dhe të krijojmë vende të reja të punës në sektorin privat për qytetarët e Vushtrrisë. Përveç krijimit të kushteve më të mira për bizneset dhe krijimit të vendeve të reja të punës, kjo është një mundësi e mirë që në Vushtrri të kemi edhe investime nga jashtë, të cilat do të krijojnë një zhvillim më të mirë ekonomik të kësaj komune", ka thënë ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani.

Oda Amerikane kërkon diskutim më të gjerë parlamentar mbi ligjet me implikime kritike

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 16 KORRIK - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj të thellë lidhur me ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-132 mbi Automjetet, respektivisht ndryshimin e dispozitave me të cilat lejohet importimi i automjeteve më të vjetra se dhjetë vjet, pavarësisht prej thirrjeve nga Oda Ekonomike Amerikane dhe shoqatat e tjera të biznesit kundër kësaj iniciative. "Oda Amerikane beson se ligji është në kundërshtim me përpjekjet e

promovuara për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, të ndërmarra brenda Bashkimit Evropian për reduktimin e emetimeve të gazrave të liruara nga automjetet e lehta dhe të rënda. Oda Amerikane, po ashtu, beson se iniciativat dhe ndryshimet e këtyre përmasave që kanë implikime të gjera në mjedis, siguri në trafik dhe shëndet duhen diskutuar më gjerësisht, ndërsa anëtarët e Kuvendit duhen ta marrin parasysh rëndësinë e një qasje më gjithëpërfshirëse vendimarrëse", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike



Amerikane. Oda Amerikane ka rekomanduar

shtyrjen e ndryshimit të ligjit të sipërcekur deri në publikimin e

të gjeturave të vlerësimit të shkaktarëve të ndotjes në vend, proces ky tashmë i iniciuar nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor me ekspertë japonezë. "Oda Ekonomike Amerikane edhe një herë përsërit thirrjen e saj ndaj politikbërësve që të reflektojnë dhe kuptojnë rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm me sektorin privat dhe shoqërinë civile, si mënyra e vetme që siguron se ligjet dhe aktet e tjera ligjore janë në shërbim të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së qytetarëve", është theksuar në komunikatën e Odës Amerikane.

Lluka: Qeveria ka marrë masa për ta përmirësuar mjedisin për investimet e huaja



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka pritur një delegacion të "The Heritage Foundation", i udhëhequr nga nënpresidenti James Jay Carafano, me të cilët ka diskutuar mbi zhvillimet e përgjithshme ekonomike në vend. Ministri Lluka me këtë rast ka njoftuar delegacionin e "The Heritage Foundation" me prioritetet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, duke u fokusuar në sektorët strategjikë si energjia dhe minierat. Kreu i MZHE-së u ndal te projektet që janë në proces të realizimit në sektorin e energjisë, që njëherësh janë investimet më të mëdha të huaja direkte të ndodhura në vend. Ai ka bërë me dije masat që

ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës për ta përmirësuar mjedisin për investimet e huaja, duke përmendur këtu përmirësimin e kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të krijimit të lehtësirave për investitorët. Ministri Lluka, duke u bazuar në përvojën e këtij fondacioni, ka shprehur gatishmërinë e tij për bashkëpunim me qëllim të përmirësimit të politikave ekonomike dhe promovimin e mundësive për investime në Kosovë. Ndryshe "The Heritage Foundation" është një institucion i pavarur joprovitabil, i specializuar në krijimin dhe promovimin e politikave publike dhe kërkime, të bazuara në parimet e sipërmarrjes së lirë, lirisë individuale, vlerave tradicionale amerikane.

Vlerësohen arritjet e Kosovës në indeksin për liritë ekonomike

Zëvendëspresidenti i Fondacionit Heritage, James Carafano, e ka njoftuar ministrin e Jashtëm, Pacolli, në lidhje me Indeksin për Liritë Ekonomike dhe të arriturat e Kosovës në këtë drejtim. "Është lajm i mirë që Kosova vazhdon të renditet relativisht lart në ranglistën botërore të Indeksit për Liritë Ekonomike dhe në vendin e dytë në rajon, pas Maqedonisë.

PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka pritur të hënën në një takim zëvendëspresidentin e Fondacionit Heritage me seli në Uashington D. C., James Carafano. Në kuadër të këtij takimi, Pacolli e ka njoftuar përfaqësuesin e këtij institucioni me zhvillimet e gjithëmbarshme në Kosovë dhe përparimet e shënuara deri më tash, ndërkohë që u diskutua në lidhje me mundësitë e rritjes së bashkëpunimit në të ardhmen. Ndërsa zëvendëspresidenti i Fondacionit Heritage, James

Carafano, e ka njoftuar ministrin e Jashtëm, Pacolli, në lidhje me Indeksin për Liritë Ekonomike dhe të arriturat e Kosovës në këtë drejtim. "Është lajm i mirë që Kosova vazhdon të renditet relativisht lart në ranglistën botërore të Indeksit për Liritë Ekonomike dhe në vendin e dytë në rajon, pas Maqedonisë. Kjo është dëshmi serioze për krijimin e sigurtë tek investitorët botërorë, që ta investojnë kapitalin e tyre në vendin tonë. Ne duhet të punojmë edhe më shumë që të renditemi vendet e para", ka thënë numri dy i Qeverisë, Behgjet Pacolli.



Asfaltohet rruga Ramosaj-Demhasaj në Komunën e Deçanit

Deçan, 16 korrik (ER) - Të hënën është asfaltuar rruga Ramosaj-Demhasaj në Carrabreg të Ulët të Komunës së Deçanit me gjatësi tri kilometra e 100 metra, duke përfshirë edhe degëzimet anësore të këtyre rrugëve. Kryetari i

Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky investim është bërë nga Ministria e Infrastrukturës rrugore në bashkëpunim me Komunën e Deçanit.



Rektori Musaj mori pjesë në një konferencë për sportin universitar në Portugali

MITROVICË, 16 KORRIK (ER) - Rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Alush Musaj, mori pjesë në Konferencën e Rektorëve që u mbajt në Universitetin e Coimbras në Portugali, më 14 dhe 15 korrik 2018, organizuar nga Federata Evropiane e Sporteve Universitare. Në këtë konferencë, ku ishin të pranishëm 40 përfaqësues të universiteteve të ndryshme evropiane, u diskutua për

rëndësinë e organizimit të sportit universitar. Në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të organizatave dhe institucioneve të ndryshme të sporteve në Evropë. Së bashku me përfaqësuesit e universiteteve diskutuan për përvojat më të mira sa i përket organizimit të sportit universitar. Konferencën e hapi presidenti i Asociacionit Evropian të Sporteve Universitare, Adam Roczek, i cili foli për rëndësinë në

aspektin shëndetësor për studentët, që ka organizimi i lojërave sportive ndërmjet universiteteve. Sipas tij, sporti është një prej pjesëve esenciale të jetës shoqërore edhe në kontekstin akademik. Rektori i Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Alush Musaj, e vlerësoi se Konferenca e Rektorëve në Coimbra, ka qenë një rast i mirë për ndarë përvojat më të mira sa i përket organizimit të sportit universitar.



'Muaji i mërgimtarëve' në Rahovec fillon aktivitetet

RAHOVEC, 16 KORRIK (ER) - Në oborin e Komunës së Rahovecit, para një numri të mërgimtarëve, të hënën kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka hapur edhe zyrtarisht aktivitetet që do të organizohen për "Muajin e mërgimtarëve". Para mërgimtarëve, të cilët ishin të pranishëm në ceremoninë e organizuar për fillimin e aktiviteteve për "Muajin e mërgimtarëve", kryetari Latifi ka thënë se mërgata jonë ka qenë

dhe vazhdon të jetë pjesë e rëndësishme e të gjitha zhvillimeve pozitive në vendin tonë. "Planifikimi i një mori aktiviteteve dhe ngjarjesh kulturore, sportive e informuese, përbën thelbin e angazhimeve tona gjatë korrikut dhe gushtit. Komuna e Rahovecit do të përplojë që në kuadër të kapaciteteve të veta materiale, teknike dhe njerëzore t'i përmbushë në mënyrën më të mirë të mundshme obligimet

ndaj mërgatës gjatë periudhës sa do të jetë për pushime në familje. Ndër të tjera, do të organizohen aktivitete të shumta kulturore e zbavitëse, si dhe do të ketë oferta konkrete për investime në Komunën e Rahovecit", ka thënë Latifi. Komuna e Rahovecit është ndër ato rajone ku numri i mërgimtarëve është relativisht i madh, respektivisht rreth 1/3 e popullsisë së përgjithshme.

Ofrohen ndihma për familjet e ndërtesës që u përfshi nga zjarri në Stantërg

MITROVICË, 16 KORRIK (ER) - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe ajo për Integritet Evropiane dhe Mbrojtje Sociale në Mitrovicë kanë marrë të gjitha masat për t'u dalë në ndihmë banorëve të ndërtesës që u përfshi nga zjarri në rrethana të panjohura në rrugën e Kristaleve në Stantërg. Në atë ndërtesë të vjetër që ishte pronë e Minierës me Flotacion "Trepça" në Stantërg po banonin disa familje me gjendje të rëndë sociale. Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Nehat Bahtiri, ka thënë se ende nuk dihen shkaqet e shpërthimit të zjarrit, por që ekipi i zjarrfikësve të komunës ka intervenuar shumë shpejt dhe nuk ka lejuar që zjarri të zgjerohet. "Ne jemi përkujdesur për ofrimin e ndih-

mës emergjente për familjen e dëmtuar më së shumti, por edhe për familjet e tjera në nevojë. Do t'i ndërmarrim të gjitha masat që familjet e ndërtesës të ndihen të sigurta", ka thënë Bahtiri. Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë për Integritet Evropiane, Nazan Kërveshi, ka theksuar se ajo ka organizuar ofrimin e ndihmave për familjet e dëmtuara nga zjarri në këtë ndërtesë. "Kemi ofruar pako me ndihma ushqimore për të gjitha familjet, ndërsa për familjen e dëmtuar më së shumti do të sigurojmë të gjitha ndihmat e nevojshme", është shprehur Kërveshi. Përveç dëmeve të konsiderueshme materiale, në këtë incident zjarri lëndime të lehta trupore kanë pësuar tre persona, të cilët janë trajtuar nga mjeku.



PROBLEME THEMELORE TË PUNIMEVE STUDIMORE (11)



Hajdin ABAZI

7. Shqyrtimi duhet të çojë në argumente të reja

Të mbash qëndrim apo të japësh vlerësim për një pikëpamje për apo kundër, për një argument apo kundërgument, për një fakt a kundërfakt në një "diskutim" domethënë studiuesi ta shprehë mendimin e vet. Respektivisht, studiuesi të tregojë se përse mendon, fjala vjen, se pikëpamja kundër është në rregull e pikëpamja për nuk është e qëndrueshme, ku e sheh mangësinë, të metën etj. Ose përse kundërgumentit është korrekt e argumenti, nëse rrjedhë nga shqyrtimi kritik, nuk është i qëndrueshëm sikurse pohon se është. Përse fakti ose kundërfakti e kanë ose nuk e kanë forcën e duhur sipas referencës në realitet. Me fjalë të tjera, kjo domethënë se studiuesi duhet të argumentojë për ose kundër një pikëpamjeje, argumenti a fakti, po qe se shqyrtimi e ka bërë t'i shquaj ato që i pretendon e nuk i ka. Ose e kundërta, studiuesi duhet të argumentojë se përse, fjala vjen, një pikëpamja për a kundër, një argument a kundër-argument, një fakt a kundër-fakt është i qëndrueshëm ose jo, ose përse është i dobët, jo i mbështetur etj. Studiuesi i mirëfilltë e ndjek logjikën e gjetjeve të shqyrtimit deri atje ku ato e çojnë, edhe po qe se kjo do ta bënte të binte ndesh me një pikëpamje apo argument që konsiderohet gjerësisht si e mbështetur. Kështu, kreativiteti i shqyrtimit është se duhet të çojë në argumente të reja, që shkojnë përtej asaj që dihet e është thënë dhe që shënon sjelljen ose kontributin konkret në një punim studimor.

8. Gjetjet duhet të shihen nga shumë këndvështrime

"Diskutimi" përfshin edhe një aspekt tjetër, gjetjet e studimit. U tha më sipër, hipotetësisht, se njëri nënkaptull i përmban gjetjet nga një studim. Në disa punime prezantohen gjetjet

me titull si "analiza e gjetjeve". Kjo është me vend, ashtu duhet të jetë. Zakonisht gjetjet analizohen nga prizmi i studimit, dhe fokusi vihet te gjetjet kryesore; kjo duhet të jetë kështu natyrisht. Për shembull, në ç'përmasë i jep mbështetje statistika e hulumtimit pikëpamjes për ose kundër? A bie ndesh me argumentin apo me kundër-argumentin? Por nuk duhet të harrohen edhe aspektet e tjera. Çfarë prirjesh tregojnë, fjala vjen, statistikat tjera? A janë mbështetja e pikëpamjes për apo kundër, e argumentit për apo kundër? Sa është kufiri ndarës i mbështetjes, a është i qëndrueshëm, shumë dallues apo kufiri ndarës është bukur i afërt, tregon një qëndrueshmëri të përafërt dhe dallimi është jo i madh. Gjetjet e hulumtimit në një studim shërbejnë për të matur, aq sa kjo është e mundur, vlerën e asaj që duhet të shqyrtohet, duke treguar mbështetjen apo prirjen për një pikëpamje (për ose kundër) apo për një argument (për ose kundër). Po kështu, kjo vlen njëllëj edhe për të vlerësuar statusin e një hipoteze, për të dhënë përgjigjen në pyetjen studimore dhe për të treguar përmbushjen e objektivit, arritjen e qëllimit, si dhe për të treguar njohjen që ofrojnë të dhënat statistikore për temën që studiohet.

9. Shqyrtimi kritik e ndihmon qëndrueshmërinë e studimit

Që të mos ketë ndonjë keqkuptim duhet nënvizuar se shqyrtimi kritik nuk kufizohet vetëm në pjesën "diskutimi" të studimit. Ai shkon edhe përtej saj. Shqyrtimi kritik, sikurse e kam thënë te pjesa e problemeve të "përfundimit", shërben edhe si qasje për të kontrolluar përputhjen tërësore të studimit. Konkretisht, fjala vjen, a është harruar të përfshihet ndonjë gjë (qëllimi, objektivat, pyetjet studimore dhe hipotezat) e shprehur në "hyrje" e që duhet të tregohet në "përfundim" se çka është bërë me të. Shqyrtimi kritik mund të nxjerrë në pah se është harruar ndonjë gjë, e që duhet të plotësohet. Ose shqyrtimi kritik mund të shquajë ndonjë shpërputhje, fjala vjen, midis gjetjeve dhe cilitdo komponent të problemit studimor - për shembull, një hipoteze. Mundet që pa dashje të mos jetë vënë re se gjetja nuk e konfirmon plotësisht hipotezën por vetëm

pjesërisht - nëse këtë e nxjerr në pah shqyrtimi kritik, atëherë duhet të konstatohet kjo në lidhje me statusin e hipotezës. Shqyrtimi kritik duhet të shohë edhe koherencën midis asaj që thuhet në pjesët përkatëse të studimit me konstatimet, fjala vjen, për përgjigjet lidhur me pyetjet studimore dhe/apo me objektivat e studimit. Shqyrtimi kritik është qasja që studiuesit i bën të mundur të jetë i ekuilibruar, të tregohet i matur, syçelë, ekzaminues dhe kritik i ashpër, ashtu që studimi të dal sa më i pjekur, sa më i plotë dhe sa më i qëndrueshëm.

10. Shqyrtimi kritik e vë çdo gjë në peshoren shkencore

Misioni kryesor i shqyrtimit kritik është që të krijojë bazën e qëndrueshme, të saktësojë mbështetjen e duhur lidhur me përfundimet që do të jepen. Secili studim që kalon nëpër filtrin e shqyrtimit kritik është një arritje serioze, pasi që ka kaluar sprovat kritike të vetë studiuesit. Kjo domethënë se shqyrtimi kritik duhet të jetë i fokusuar për të testuar ato që pohohen si të vërteta ose si të sakta, për të parë se sa ato janë të tilla. Ai e vë çdo gjë në peshoren shkencore. Sa më i rreptë të jetë shqyrtimi kritik aq më mirë është, sepse nëse nga një filtër i ashpër kalohet me sukses, atëherë ka gjasa që edhe të tjerët nuk do të mund të gjejnë diçka jo të duhur, pasi që shqyrtimi kritik ka ekzaminuar me korrektësi studimin. Shqyrtimi kritik, do të duhej të ishte e vetëkuptueshme, nuk vepron në stilin kjo është mirë e kjo është keq, ose kjo është e vërtetë e kjo jo, kjo është korrekte e kjo tjetra jo. Për të qenë shqyrtim kritik, duhet të tregohet se përse është i mirë ose i keq, përse është i vërtetë ose jo, përse është korrekt ose jo, duke nxjerrë në pah anët e dobëta ose anët e qëndrueshme, të argumentohet për ose kundër.

11. Diskutimi është arena intelektuale e shkencore

"Diskutimi" qoftë si nënkaptull apo qoftë si kapitull më vete është ajo hapësirë kur duhet të shfaqet studiuesi, i cili, pasi ka parashtruar si rezultat i punës që ka bërë ato që i ka konsideruar të lidhura me temën

që shtjellon, duhet t'i ekzaminojë ato, për të vënë në kan-darë pohimet, vlerësimet, pretendimet dhe konstatimet e shprehura. Kjo është fushëbeteja ku shfaqet studiuesi, i cili shfaq reflektimet e veta, mendimet e veta, tregon ato që ka hetuar se nuk janë sikurse pretendojnë ose sikurse duken, tregon se përse nuk janë të tilla, çka është që nuk shkon dhe cili është kuptimi i saj, dhe kështu bën një rigjykim, rivlerësim dhe konstatim, pas një shoshitje paraprake. Në këtë kuptim, "diskutimi" është arena e shqyrtimit kritik, këtu shfaqet liria e mendimit, aftësia gjykuese e vlerësues, kapaciteti depërtues dhe zhbirues i studiuesit, si dhe guximi intelektual e shkencor dhe integriteti njerëzor për të shprehur atë që e heton dhe që konstaton se është e mbështetur. Pikërisht këtu qëndron kreativiteti i mendimit kritik, sepse e bën studiuesin të hetojë (natyrisht nëse ka) mangësi atje ku pohohet se nuk ka dhe gjen qëndrueshmëri atje ku besohet se nuk ka, dhe mbi këtë bazë shpreh argumentimin e vet përkatës. Një punim që nuk e përmban, aty ku konsiderohet i duhur, "diskutimin" si shqyrtim kritik, është një punim anemik, me karakter të zbehtë dhe nuk arrin të kalojë caqet deskriptiviste, të shkruaj faqet të tëra, pa sjellë ndonjë gjë si tejkallim i asaj që dihet. Krejt në fund dua të theksoj se në një punim nëse ka diçka që re që sillet aty, nëse ka diçka që lë gjurmët origjinale të studiuesit, atëherë ajo është pikërisht pjesa "diskutimi", dhe në kuadër të saj, por jo vetëm, qasja kritike. Pikërisht "diskutimi" dhe qasja kritike, respektivisht shqyrtimi, ekzaminimi dhe testimi e pohimeve (pikëpamjeve për apo kundër, argumenteve apo kundër-argumenteve) që pretendojnë të jenë korrekte, ose të vërteta, ose koherente, ose të mbështetura, i japin gjallëri studimit, tension dhe arsyejnë tërë mundin e studiuesit, në shkallën e gjetjeve të tij.

PËRMBYLLJE

Ajo që dua në fund të theksoj e ta bëjë të qartë është se unë nuk kam sugjeruar një strukturë të rreptë, të këtillë dhe jo tjetër si të vetmen shkencore apo akademike. Ajo që kam tërhequr vëmendjen është te fakti që kjo strukturë, përkatësisht problemi studimor, duhet të përkufizohet në mënyrën

sikurse për të, karakterin e studimit dhe aspektin metodologjik është e natyrshe ose që korrespondon, ashtu që studimi të jetë sa më i plotë. Po e theksoj se liria akademike qëndron te zgjedhja e saktë e asaj që një studim e kërkon, dhe jo që në emër të saj të shkruhen punime që nuk kanë qëndrueshmëri shkencore nga aspekti metodologjik. Në shqyrtimin deri këtu kam ngritur disa aspekte të mënyrës se si shkruhen punime të ndryshme studimore. Sigurisht, nuk i kam përfshirë të gjithat, dhe as që e kam pretenduar. Për shembull, nuk jam rrekur fare me aspektin e teorive të ndryshme sipas të cilave apo bazuar në të cilat një temë duhet të studiohet. Po ashtu, fare pak dhe vetëm aty-këtu e kam përmendur rolin e mentorëve, që janë udhëheqës shkencor të kandidatëve në realizimin e studimit. Kam lënë anash edhe aspekte të tjera pa i theksuar, si fjala vjen se si bëhen citimet apo parafrazimet; gjë që në shumicën e rasteve bëhen jo si duhet. Nuk e kam shqyrtuar fare atë se si duhet të përzgjidhet një citat, që të jetë mirëfilli në funksion të mbështetjes teorike. Nuk kam thënë asnjë fjalë për atë se si jepen referencat në tekst dhe si ato shkruhen në fund te bibliografia. Po ashtu nuk i kam zënë në gojë fare aspektet gramatikore dhe ato drejtshkrimore. Nuk kam përmendur fare plagjiaturën, që është një dukuri jo pak shqetësuese. Të gjitha këto janë gjithsesi me peshë dhe kanë ndikim në cilësinë e studimit, gjë që do të ishte mirë t'i merrte ndokush në konsideratë për t'i studiuar. Unë e kam parë më të udhës që t'i shtjelloj ato probleme që janë themelore për një studim, me të cilat jam rrekur deri këtu. E kam bërë këtë i shtytur nga shkak se këto aspekte të shqyrtuara këtu po shprehen me vite si një tendencë e kamufluar me standarde formale, por me mangësi të shumta përmbajtjesore, teorike e metodologjike. Këto janë pengesat themelore, pa tejkallimin e të cilave nuk do të mund të shkohet më tutje, nuk do të mund të bëhen punime studimore të mirëfillta sipas standardeve bashkëkohore të bërjes shkencë.

(Fund)

(Autori është prof. ass. dr. dhe ka ligjëruar për shumë vjet lëndët Shkrimi akademik dhe Metodologjia e hulumtimit shkencor)

Mogherini: Miqësia me ShBA-në nuk ndryshon

BRUKSEL, 16 KORRIK - E kemi qartësisht në mendje se kush janë miqtë tanë dhe ShBA-ja sigurisht që është, e kemi thënë çdoherë, pavarësisht se kush është në krye të administratës në Uashington, deklaroi të

hënën shefja e diplomacisë e BE-së, Federica Mogherini, duke iu përgjigjur mbi akuzat e fundit të presidentit Trump. "Miqësia me Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ndryshon, i konsiderojmë miq,

partnerë dhe gjithmonë do të vazhdojmë t'i konsiderojmë të tillë", u shpreh ajo. Në një intervistë për CBS, Trumpi kishte thënë se ShBA-ja ka "shumë armiq", përfshirë edhe Bashkimin Evropian.



Trumpi shpreson në marrëdhënie të jashtëzakonshme ShBA - Rusi



Pas takimit të vitit të mbajtur në Helsinki, presidenti amerikan Donald Trumpi tha se shpreson se ShBA-ja dhe Rusia do të përfundojnë me marrëdhënie të jashtëzakonshme dhe se bashkëpunimi me Rusinë është një gjë e mirë. Kurse presidenti rus, Putin, tha se ai dhe Trumpi morën hapin e parë të rëndësishëm për t'i përmirësuar marrëdhëniet ShBA-Rusi

hënie të jashtëzakonshme dhe se bashkëpunimi me Rusinë është një gjë e mirë, jo një gjë e keqe.

Është ky samiti i parë dypalësh i liderëve të të dyja vendeve qysh në prill të vitit 2010.

Përpara takimit, Trumpi tha se hetimet e agjencive amerikane mbi ndërhyrjen e dyshuar të Ruisë në zgjedhjet presidenciale në ShBA, më 2016, i kanë përkeqësuar rëndë marrëdhëniet e Uashingtonit me Moskën.

"Marrëdhëniet tona me Rusinë nuk kanë qenë kurrë më të këqija falë shumë viteve të marrëzisë dhe budallallëkut të ShBA-së dhe tani 'gjuetisë së shtrigave'", shkroi Trump në "Twitter", duke iu referuar hetimeve që po bën këshilltari i posaçëm amerikan, Robert Mueller.

Ministria e Jashtme e Ruisë, e cila i ka akuzuar kundërshtarët e brendshëm të Trumpit dhe establishmentin amerikan për pengimin e përpjekjeve për përmirësimin e marrëdhënieve, e pëlqeu postimin e Trumpit. Takimi i dy liderëve ndodhi në kohën kur marrëdhëniet ShBA - Rusi janë më të tensionuara se kurrë qysh nga koha e Luftës së Ftohtë për shkak të aneksimit të gadishullit ukrainas të Krimesë nga Rusia në vitin 2014, intervenimit ushtarak të Moskës në lindje të Ukrainës dhe në Siri, si dhe ndërhyrjes së saj në zgjedhjet në ShBA.

Gjatë një takimi me presidentin e Finlandës, Sauli Niinisto, përpara takimit me Putinin, Trumpi tingëlloi pozitiv. I pyetur se çfarë do t'i thotë Putin, ai tha: "Do të jemi mirë, fale-

minderit". Në këtë takim, Trumpi tha se "NATO-ja nuk ka qenë kurrë më e fuqishme dhe kurrë më e bashkuar". Komentet pasojnë samitin e aleancës në Bruksel, më 11 dhe 12 korrik, ku vendet anëtare janë pajtuar t'i rrisin shpenzimet në mbrojtje.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha para takimit Trump - Putin, se Moska nuk pret që ai të jetë i lehtë. "Natyrshë se Siria do të diskutohet nga dy presidentët. Të gjithë e dimë se çfarë mendon Uashingtoni për Iranin. Por, në të njëjtën kohë, Irani është partner yni i mirë në tregti, bashkëpunim ekonomik dhe dialog politik. Pra, nuk do të jetë një shkëmbim i lehtë i pikëpamjeve", tha Peskov.

Rusia, megjithatë, shpreson se samiti do të jetë hapi i parë në tejkalimin e krizës në marrëdhënie, tha ai. "Presidentët Trump dhe Putin e respektojnë njëri-tjetrin dhe shkojnë mirë. Nuk ka agjendë të qartë. Do të përcaktohet nga vetë krerët e shteteve", shtoi Peskov.

Samiti në Helsinki u zhvillua nën hijen e një mjedisi të ndarë politik në Shtetet e Bashkuara, ku Mueller po udhëheq hetimet për kontakte të mundshme të paligjshme midis agentëve rusë dhe fushatës së Trumpit në vitin 2016. Më 13 korrik, Departamenti amerikan i Drejtësisë tha se një juri e madhe i ka akuzuar 12 zyrtarë të inteligjencës ruse për rolin e tyre në piraterimin e Partisë Demokratike në ShBA dhe për publikimin e e-maileve të vjedhura dhe informacioneve të tjera gjatë fushatës presidenciale. Shtëpia e Bardhë, më 14 korrik, i refuzoi thirrjet e disa anëtarëve të Kongresit për të anuluar takimin Trump - Putin si pasojë e akuzave që tani kanë rritur presionin e brendshëm mbi Trumpin që të marrë një qëndrim më të ashpër ndaj Putin.

HELSINKI, 16 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se diplomacia është vendimtare dhe se dialogu produktiv është një gjë e mirë për ShBA-në, Rusinë dhe botën. Trumpi i bëri këto komente në një konferencë me gazetarë në Helsinki, pas takimit që mbajti atje me presidentin rus, Vladimir Putin.

Putini tha se ai dhe Trumpi morën hapin e parë të rëndësishëm për t'i përmirësuar marrëdhëniet ShBA - Rusi. Në

fillim të takimit, Trumpi e përgëzoi Putinin për organizimin e suksesshëm të Kampionatit Botëror të Futbollit, përpara se të përvijonte disa nga temat që do t'i prekin gjatë bisedimeve. "Dua t'ju përgëzoj për një kampionat vërtet të mirë, një nga më të mirët", tha Trumpi, duke shtuar se me Putinin do të diskutojë për gjithçka, nga tregtia deri te Kina. Ai tha se shpreson se ShBA-ja dhe Rusia do të përfundojnë me marrëd-

Shifra rekorde të emigrimit nga Mbretëria e Bashkuar

LONDËR, 16 KORRIK - Numri i qytetarëve të Bashkimit Evropian që kanë emigruar nga Mbretëria e Bashkuar vitin e kaluar, ka qenë më i larti i regjistruar ndonjëherë, tha Zyra e Statistikave Kombëtare. Sipas saj, 139 000 njerëz kanë ikur nga ky vend më

2017.

I vetmi vit tjetër kur shifra e emigracionit ishte e lartë ka qenë viti 2008, me 134 000.

Zyra e Statistikave Kombëtare, po ashtu, tha se migrimi në Mbretërinë e Bashkuar nga BE-ja ka qenë 101 000 njerëz vitin e

kaluar - që është shifra më e ulët në pesë vjet.

Të dhënat vlejné për vitin e parë të plotë kalendarik që nga votimi për Brexit, apo për daljen e Britanisë nga BE-ja. Referendumi për Brexit është mbajtur më 23 qershor të vitit 2016.



Albulena Bajraktari, 'Miss social media', po i radhitë sukseset hap pas hapi

Ismail REXHEPI

FERIZAJ, 16 KORRIK - Të shkruash për vajzën e re, Albulena Bajraktari, është një mrekulli. Kjo bukuroshe në "Miss Univers Kosova 2018" arriti ta marrë çmimin prestigjioz të "Miss social media". Ky çmim ka vlerë të papërshkrueshme, sepse ky titull iu dha nga populli. Ta takosh Albulenën është një kënaqësi e vërtetë. Albulena është një vajzë jo vetëm shumë e bukur, por me plot kuptimin

edhe në Dyseldorf të Gjermanisë. Po ashtu, ajo ka falënderuar ekipin përzgjedhës që ka vlerësuar drejt, në veçanti Labinot Gashin e Atdhe Gashin që, siç thotë ajo, e kanë respektuar shumë.

"Epoka e re": Të arriturat e juaja janë të mëdha, mirëpo para se ta merrnin titullin e "Miss Univers Kosova 2018", cilat ishin aktivitete e juaja?

Bajraktari: Tash po përmendi edhe një aktivitet timin. Në periudhën e lartpërmendur unë

rivale në të njëjtën kohë. Kam marrë pjesë në disa evenimente të bukurisë, por "Miss Univers Kosova 2018" është një kënaqësi për mua që nuk do ta harroj kurrë.

"Epoka e re": A është pasion yti modelimi?

Bajraktari: Sigurisht po. Më pëlqen arti, në këtë çast pasarelave dhe fotografisë. Më pas, shohim...

"Epoka e re": Sa të mbështetë familja në këtë pasion?

Bajraktari: Mendoj se është një mbështetje shumë e madhe për mua. Më qëndrojnë gjithnjë pranë. Mami ka qenë gjithnjë një shtysë që unë të jem pjesëmarrëse. Mami është një këngëtare e njohur e estradës së Kosovës, pra ajo është Fikrije Bajraktari.

"Epoka e re": Të pëlqen ta vazhdozh rrugën e modelueses dhe të prezantueses. Cilat janë ëndrrat në sirtar për ju në të ardhmen?

Bajraktari: Thashë dhe më parë se më pëlqen shumë modelimi. Sa i përket prezantimit, pse jo, nëse më jepet mundësia. Ëndrra në sirtar tani kam shumë, por më mirë të mos e "hap" sirtarin.



edhe një personalitet. Ka kulturë, ka vlerë, ka shkollë. Me një fjalë, është mrekullia e Zotit. Ajo në fillim na tha se është në Shkollën e Mesme të Financave në Belgjikë. Është bija e këngëtares së njohur Fikrije Bajqinovci dhe mbesa e atdhetarit Qazim Bajraktari, pra prijësit të Bajrakut të Ostrazubit, i cili bëri rezistencë kundër okupatorit serb deri në vdekje. Ai ishte nëpër malet e Kosovës që nga Lufta e Dytë Botërore. I gjithë angazhimi i tij ishte për Shqipërinë etnike.

Mrekullia e Albionës është jo vetëm që mori këtë çmim me vlerë që i hapi rrugë në vijim asaj, por Albiona është edhe një nxënëse e mrekullueshme në mësim. Ajo zotëron edhe tri gjuhë të botës, përveç gjuhës kombëtare të vet, ajo flet edhe frëngjisht, gjermanisht dhe anglisht. Albiona që kur i kishte 15 vjet u mor me modelime në Agjencinë e Modelimit në Belgjikë.

Gjatë kësaj periudhe ajo ka bërë një katalog me fotografi që është shpërndarë në katër shtete të botës: Francë, Itali, Spanjë dhe Belgjikë. Ajo është ftuar nga shumë agjenci botërore për të bërë fotografi me të.

Albiona ka nënshkruar kontratë

kam qenë e angazhuar në sfilatat në një agjenci në Gjermani.

"Epoka e re": Si konkurrove?

Bajraktari: Këto ditë isha në Kosovë me mamin tim, këngëtares Fikrije Bajraktari. Kur e pashë konkursin për "Miss Univers Kosova 2018" vendosa të konkurroja dhe më doli të jetë një hap i qëlluar, sepse u ndava me një çmim shumë me vlerë që më tutje më hapë rrugë për të ecur përpara.

"Epoka e re": Jeni shpallur "Miss social media" mes 16 vajzave të tjera të bukura. Ç'do të thotë ky çmim për ju?

Bajraktari: Ishte privilegj të marrësh titull në këtë garë të bukurisë. Kjo do të më japë përparësi të ec drejt titullit me prestigjioz të bukurisë. Pra, ma jep mundësinë ta përfaqësoj Kosovën në gara ndërkombëtare.

"Epoka e re": A krijuat miqësi me vajzat e tjera?

Bajraktari: Ka qenë një nga përvojat më të veçanta për mua. Pata mundësinë të njoh e të lidh miqësi, dhe jam e sigurt se do të jenë miqësi që do të jetojnë gjatë në kohë. Ne ishim mike dhe



E rrallë

Presidenti i Tanzanisë: Godisni të burgosurit dembelë

Presidenti i Tanzanisë ka bërë thirrje që të burgosurit të punojnë me orë të gjata dhe të dënohen nëse janë dembelë. John Magufuli po fliste në ceremoninë e emërimit të një shefi të ri burgjesh. Grupet e të drejtave të njeriut e kanë akuzuar atë për rritje të intolerancës.



FOTO E DITES



Presidenti francez Emmanuel Macron shihet duke festuar gjatë ndeshjes finale mes Francës dhe Kroacisë në Kupën Botërore të Futbollit 2018 në stadiumin Luzhniki në Moskë.

E jashtëzakonshme

Banorët masakrojnë rreth 300 krokodilë

Një turmë fshatarësh në Indonezi kanë vrarë rreth 300 krokodilë në një rezervë natyrore për kafshët në Papua West. Masakra ishte një hakmarrje për një burrë që mendohet se është vrarë nga një kafshë në vend. Zyrtarët dhe policia thanë se nuk ishin në gjendje ta ndalonin sulmin dhe kanë ngritur akuza. Vrasja e një



specie të mbrojtur është një krim që dënohet me gjobë ose burgim në Indonezi.

BARSOLETA E DITËS



Policia ndalon dy pijanecë:
- Ku e ke shtëpinë ti?
- Nuk e di.
- Po ti tjetri?
- Unë një kat më lart.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Vetëm gjatë vikendit
në ora 16:00**

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Nervozizmi që do të keni sot përgjatë

gjithë ditës nuk do t'ju lejojë ta shijoni këtë ditë pushimi.



DEMI
Mjaft aktivitete dhe surpriza të

këndshme parashikohen për të lindurit e kësaj shenje gjatë kësaj dite. Do të jeni të rrethuar nga dashuria.



BINJAKËT
Një ditë plot ngjyra ashtu siç ndiheni

edhe ju sot. Kudo që jeni, me familjen apo me miqtë, çdo gjë do të shkojë shumë mirë.



GAFORRJA
Sot keni nevojë për përkëdhelje

dhe pak intimitet me partnerin, por nuk do ta realizoni dot. Të afërmit tuaj ju kanë zbarkuar në derë.



LUANI
Keni mjaft opsione interesante sot

për ta kaluar ditën dhe nuk dini ke të zgjidhni. Miqtë duan një ditë në natyrë dhe vendi do t'ju pëlqejë pa masë.



VIRGJËRËSHA
Ilaçi i ditës tuaj sot do të jenë

blerjet. Ata që ju shoqërojnë do të kënaqen sepse ju bëni shumë dhurata.



PESHORJA
Sot jeni ju protagonistët e situatave të

ndryshme që ju ofron dita. Do të dini t'i bëni zgjedhjet e duhura.



AKREPI
Edhe pse dita do të jetë shumë e

rrëmujshme, mbrëmja paraqitet e qetë dhe në shoqëri të mirë.



SHIGJETARI
Partneri nuk do të kuptojë një takim pune

që do t'ju dalë sot papritur. Debate dhe zënka parashikohen gjatë pasdites.



BRIC-JAPI
Këqkuptimet që do të lindin së

fundmi nuk do të ndodhin për shkakun tuaj, kështu që nuk keni pse të ndiheni fajtor.



UJORI
Mos qëndroni të mbyllur në shtëpi

sot. Dita është shumë e bukur dhe duhet shijuar në çdo çast. Do ta kërkon shoqërinë e një miku.



PESHQIT
Sot çdo gjë duket sikur

shkon sipas planit dhe nuk do të ndiheni të rrezikuar aspak nga një koleg që ju ka vënë shkopinj nën rrota.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEGIA WARSAW - CORK

3+

VALLETTA - KUKESI

2

THE NEW SAINTS - SKENDIJA '79

2

Drita shkon në Suedi të lë përshtypje të mirë

Drita e zhvillon ndeshjen kthyesë ndaj Malmos sonte me fillim nga ora 19:00 në Suedi. Bujar Shabani ka thënë se gjilanasit synojnë të lënë përshtypje sa më të mirë si klub, por edhe si futboll i Kosovës. "Synimi ynë është të paraqitemi mirë dhe të lëmë përshtypje sa më të mirë për klubin tonë dhe Kosovën", ka thënë Bujar Shabani

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, sonte (e martë) do ta zhvillojë ndeshjen kthyesë në kuadër të rrethit të parë kualifikues të Ligës së Kampioneve dhe, me gjasë, edhe të fundit për këtë edicion. Kundërshtarë e skuadrës nga Gjilani do të jetë kampionia e Suedisë, Malmo, e cila në ndeshjen e parë në stadiumin "Adem Jashari" fitoi me rezultat 0-3. Bujar Shabani ka thënë të hënën për "Epokë e re" se synimi i kampioneve të Kosovës është të paraqitet sa më mirë në ndeshjen që do të zhvillohet nga ora 19:00. "Në këtë ndeshje do të luajmë pa presion dhe do

të përpiqemi ta vëmë në vështirësi skuadrën kundërshtarë, pasi ne nuk kemi më çfarë të humbim. Do të luajmë një lojë sulmuese për tifozët që na kanë mbështetur në vazhdimësi. Shpresoj të kemi edhe fatin me vete, sepse në ndeshjen e parë nuk kemi pasur fat. Synimi ynë është të paraqitemi në mënyrë sa më të mirë dhe të lëmë një përshtypje sa më të mirë për klubin tonë dhe Kosovën", ka thënë Shabani.

Për paraqitjen e parë të Dritës në ndeshjen ndaj Malmos (0-3), analisti dhe ish-futbollisti i kësaj skuadre, Genc Sermaxhaj, ka thënë se përvoja e Dritës ishte e pamjaftueshme për t'i bërë ballë skuadrës suedeze. "Malmo tregoi se është ekip më shumë përvojë, kurse

Dritës i mungoi përvoja në gara të tilla, cilësia e futbollistëve kundrejt Malmos me përvojë, futbollistë me efikasitet para portës. Ata iu lejuan hapësira futbollistëve të Dritës, më pas me tri pasime realizonin gola. Kjo bëri edhe dallimin në atë ndeshje", kishte deklaruar Sermaxhaj. Drita në këtë edicion në arenën ndërkombëtare e ka mposhtur skuadrën Santa Coloma të Andoras me rezultat 2-0, edhe Lincoln Red Imps FC nga Gjibraltari me rezultat 4-1. Skuadra tjetër që e përfaqëson Kosovën në garat ndërkombëtare, FC Prishtina të enjten nga ora 19:00 e pret në Mitrovicë skuadrën e CS Fola Esch. Ndeshja e parë në mes këtyre dy skuadrave e zhvilluar në Luksemburg përfundoi 0-0.

SHKURT**Hamiti largohet nga Drenica**

Futbollisti kryesor i KF Drenica, Genc Hamiti, ka vendosur të largohet nga skuadra kuqezi për shkak të pamundësisë për t'i kryer obligimet financiare. Lajmin për largim nga Drenica e ka bërë vetë Hamiti për "Telegrafin". "Zyrtarisht kam shkëputur marrëdhëniet kontraktuale me klubin e Drenicës. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së përbushjes së obligimeve financiare nga klubi. E falënderoj dhe i dëshiroj suksese Drenicës", ka deklaruar Hamiti, i cili gjatë afatit kalimtar të janarit ishte ndër lojtarët më të kërkuar në Kosovë.

Gjyqtarët nga Kosova referojnë në Ligën e Evropës

Gjyqtarët nga Kosova do të vazhdojnë të jenë të pranishëm në garat evropiane. Kësisoj, një nga gjyqtarët më të mirë në Kosovë vitet e fundit, Genc Nuza, do ta ndajë drejtësinë në Ligën e Evropës. Prishtinasi do të gjykojë në shtetin e Norvegjisë, ndeshjen mes Sarpsborg 08 dhe IBV Vestmannaeyjar nga Islanda. Ndeshja e parë në mes të këtyre skuadrave në Islandë ka përfunduar me fitore të thellë të ekipit norvegjez 4-0. Ndihmës të Nuzës në këtë takim do të jenë Fatlum Berisha dhe Bujar Selimaj. Edhe gjyqtari i katërt do të jetë nga Kosova, Visar Kastrati.

500 mijë tifozë mirëpresin heronjtë e tyre në "Champs-Elysees"

Rreth 500 mijë francezë mbushën Champs-Elysees pasditen e së hënës, ku pritën heronjtë e tyre, të cilët rikthyen në Francë Kupën e Botës pasi mundën Kroacinë 4-2 në finalen e Botërorit një ditë më parë. Një festë e jashtëzakonshme pushtoi Francën një ditë më parë, ndërsa ajo ka vazhduar gjatë dhe ende nuk është mbyllur. Ndërkohë, heronjtë francezë kanë zbritur në tokën e tyre të cilën e kthyen në "çatinë e botës" një ditë më parë pas triumfit në Rusi.

Prezantohet CR7: Jam gati për Juven

TORINO, 16 KORRIK - Vizitat mjekësore janë mbyllur me sukses. Nuk është paraqitur asnjë problem fizik apo shëndetësor. Pas një sezoni të gjatë, Cristiano Ronaldo është gati të zbresë në fushë për skuadrën e tij të re, Juventusin, me të cilin pritet të luajë në

katër sezonet e ardhshëm. Mijëra tifozë kanë shoqëruar këtë ditë të parë si juventin të CR7, që pasi ka përfunduar vizitat, ka qenë në qendrën stërvitore të skuadrës bardhezi, ku ka takuar trajnerin Max Allegri dhe shokët e rinj të skuadrës. Me disa prej tyre

njihet, natyrisht si rival, ndaj nuk kanë munguar përqaftimet. "Jam gati për ta nisur sezonin e ri me Juventusin. Jam i lumtur që ndodhem në këtë skuadër", kanë qenë fjalët e para të portugezit. Sulmuesi portugez do të përfitojë 31 milionë euro për sezon në katër vjetët e ardhshëm.



Prishtina kërkon përkrahje për ndeshjen ndaj Fola Esch

PRISHTINË, 16 KORRIK - FC Prishtina u ka bërë thirrje publike tifozëve për prani masive në stadiumin olimpiq "Adem Jashari" në Mitrovicë, ku kryeqytetasit do ta zhvillojnë ndeshjen e kthimit të

rrethit të parë kualifikues të Evropë Ligës. "Bardhekaltrit" do të përballen të enjten nga ora 19:00 me ekipin nga Luksemburgu, CS Fola Esch, me të cilin kanë barazuar në duelin e parë në

udhëtim. "Prishtina ka nevojë për ju. E enjte, 'Adem Jashari', ora 19:00", ka bërë thirrje skuadra e Prishtinës nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare në "Facebook".



Pesë fytyrat e triumfit të Francës

Paris, 16 prill - Kupën e ka marrë me vete Varane jashtë stadiumit: është zëvendëskapiten por, ndoshta, Hugo Lloris ka paguar për atë gabim të bërë në rastin e golit të Mandzukiqit. E ka mbajtur në krahë si të ishte një fëmijë, e ka mbrojtur nga shokët e papërmbyajtshëm të skuadrës që kalojnë mbrapa tij me altoparlant, të udhëhequr nga Umtiti. Franca është kampione e botës dhe suksesi ka fytyra të ndryshme.

MBAPPE

E para, ajo më mediatike, është ajo e më të voglit. Kylian Mbappe ka kapur Pelen në një tjetër statistikë (gol në finale nga një adoleshent), ka lënë mbrapa, ka shumë mundësi përfundimisht, Messin dhe Ronaldon për botërorët e futuar dhe e ka komentuar suksesin me fraza kërcënuese: "Nuk dua të jem një kalimtar në futboll. Kjo fitore është një mesazh". Ndjesia është se ai sapo ka filluar.

GRIEZMANN

Nëse "i vogli" ka vjedhur vëmendjen e kamerave, në fushë ndihet gjithmonë ndikimi i Griezmannit. Transformimi i penaltisë ka qenë gjëja më e lehtë për të, aq sa kishte menduar ta godiste me stilin 'Panenka' (e ka zbuluar pas finales). Por, mbi të gjitha, nga këmbët e tij kanë ardhur goditje dënimi dhe këndi vendimtar: njëra për kokën e Varanes në çerekfinale, për kokën e Umtitit në gjysmëfinale, për atë të Mandzukiqit në finale. Më shumë se vendimtar.



POGBA

Por ka qenë edhe Botërori i Pogbas: ka shkuar në Rusi duke marrë me vete disa dyshime pas një sezoni zhgënjyes për standardet e tij. Dyshime që janë fshirë në Botëror. Ka dominuar mesfushën që në ndeshjet e para, ka provokuar autogolin kundër Australisë dhe, me kalimin e kohës, ka gjetur lëvizjet që e kanë bërë një nga lojtarët më të shtrenjtë të të gjitha kohëve. Në finale ka qenë një yll i vërtetë: happe loje të mrekullueshme, gjithë kohën në lëvizje, golin e realizuar pas një aksioni të nisur nga vetë ai. Më pas, një lider i festuar nga grupi.

VARANE

Finalja e njëmbëdhjetë e luajtur, finalja e njëmbëdhjetë e futuar. Dhe kjo ishte më e rëndësishmja:

Varane është një makineri titujsh, përveçse ndërhyrjesh shpëtimtare në mbrojtje. Lider i një mbrojtjeje që është pika më e fortë e skuadrës: nga aty fillon gjithçka, në pritje të shpërthimit të sulmuesve. Ose edhe të një episodi, ndoshta me atë për protagonist.

DESCHAMPS

Por ylli i dytë në fanellën e "Bleus" mban firmën e Didier Deschamps, njeriu që bashkon dy brezat fitues, njëzet vjet më pas. Loja e skuadrave të tij nuk do të jetë kurrë mahnitëse, por ka arritur të marrë kupën me gjashtë fitore dhe një barazim, duke eliminuar Argentinën, Uruguain dhe Belgjikën, dhe duke realizuar katër gola në finale. Didi ka diçka të veçantë dhe do të mbetet gjithmonë i tillë në historinë "Bleu".

SHKURT

Usain Bolt do ta vazhdojë karrierën si futbollist

Atleti Usain Bolt pritet ta fillojë angazhimin në futbollin profesional me lajmet e fundit. Ai është afër nënshkrimit me klubin e futbollit në Australi, Central Coast Mariners. Klubi nga Australia nuk ka arritur të nënshkruajë marrëveshje me Fernando Torresin në muajin e kaluar, kështu që ata janë drejtuar nga atleti i pensionuar 31-vjeçar, i cili përvojën e vetme në futboll e ka me goditjet e tij për reklamat e ndryshme sportive. Fituesi i tetë medaljeve të arta olimpike pritet të nënshkruajë një kontratë gjashtëmujore me mundësi për ta vazhduar atë nëse tregon sukses.

Messi e dëshiron Pogban te Barça

Barcelona është duke kërkuar patjetër një zëvendësues për Andres Iniestën. Por, ashtu siç ndodh në shumicën e rasteve, drejtuesit e klubit kanë marrë më parë edhe mendimin e lojtarit kryesor të tyre, Lionel Messit. Dhe, sipas asaj që raportojnë mediet spanjolle, "ylli" i Argentinës u ka rekomanduar Paul Pogban. Mesfushori i Manchester Unitedit është një lojtar i cili është shpallur kampion bote me Francën, duke shënuar një gol të rëndësishëm. Por, nuk ka qenë vetëm në finale, pasi Pogba ka dhuruar paraqitje të mira në të gjithë Botërorin.

Mbappe refuzon Realin

Pas largimit të Cristiano Ronaldos nga "Santiago Bernabeu", klubi spanjoll i Real Madridit kërkon patjetër të gjejë një zëvendësues. Emri që jo pak herë u përmend ishte ai i 19-vjeçarit, Kilian Mbappe. Lojtari francez u ble vjet nga PSG-ja për shifrën e 180 milionë eurove. Ndërkohë që me kalimin e lojtarit te ekipi kampion i Spanjës ai ka rritur nivelin e tij, madje e tregoi edhe në Botëror se çfarë është në gjendje të bëjë. Në lidhje me një largim nga PSG-ja, Mbappe ka deklaruar: "Është vetëm fillimi për mua dhe jam në hapat e parë. Dua të qëndroj këtu dhe ta vazhdoj rrugën që kam nisur. Jam lojtar i PSG-së dhe nuk largohem".

Shtatë lojtarë largohen nga Barcelona

Barcelona pritet të bëjë shumë largime të futbollistëve gjatë këtij afati kalimtar. Sipas medieve spanjolle në listën e largimeve të trajnerit, Ernesto Valverde janë Andre Gomes, Aleix Vidal, Marlon Santos, Munir, Douglas, Rafinha dhe Sergi Samper. Ndërsa kjo skuadër pritet të sjellë futbollistë të dëshmuar në "Camp Nou".

Joshua mbron titujt më 22 shtator

Dy sfidat e fundit Joshua i ka zhvilluar në Kardif, por dy duelet e radhës i ka planifikuar në Londër. "Mezi po pres të rikthehem sërish në ring. Më duket sikur ka kaluar një kohë shumë e gjatë nga muaji mars, kur zhvillova duelin e fundit", tha Joshua, që duke folur për rivalin rus shton: "Povetkin është një sfidant shumë i rrezikshëm, ndaj po përgatitem seriozisht dhe me shumë kujdes. Ai ka një përvojë të madhe në ring dhe nënvlerësimi do të ishte një gabim i madh nga ana ime", ka thënë Anthony Joshua. "Nuk e kam ndërprerë stërvitjen në 10 javët e fundit, por 10 javët në vazhdim do të jenë edhe më intensive për mua, si në anën fizike ashtu dhe atë psikologjike. Dua të jem në formën optimale më 22 shtator, për të mos zhgënjyer fansat që do të më ndjekin në stadium", u shpreh Joshua. Rusi Povetkin është një rival i fortë, që në duelin e fundit ka mundur me "KO" David Price, në të njëjtën ditë që Joshua mundi Parker dhe i mori titullin kampion. "Kjo sfidë është një mundësi e artë për mua. Kam kohë që e pres këtë çast, ndaj nuk do të zhgënjëj", ka deklaruar Povetkin.

Gavazaj transferohet në Rusi

TIRANË, 16 KORRIK - Enis Gavazaj është transferuar edhe zyrtarisht në Rusi. Mesfushori 23-vjeçar është bërë zyrtarisht pjesë e Yenisey Krasnojarsk, kurse firmosi kontratën me klubin nga Siberia pas shkëlqimit në Kategorinë Superiore, por edhe në arenën ndërkombëtare. Pas mbylljes së marrëveshjes, mesfushori pozoi me drejtuesit e klubit dhe menaxherin e tij, Shkumbin Qormemeti, ndërsa menjëherë erdhi edhe zyrtarizimi i tij në faqet zyrtare të ekipit të ri. Për djaloshin e Lindur në Prizren, Yenisey do të jetë klubi i katërt në karrierë, pas aventurave me Gent dhe Roeselare në



Belgjikë, dhe dy vjetëve të kaluara te Skënderbeu. Në Rusi aktivizohen

edhe tre shqiptarët: Bekim Balaj, Odise Roshi dhe Bernard Berisha.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova –
University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit



Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L.-212; Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6, nën paragrafi 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); nenit 13 paragrafi 1, neni 10 nën paragrafi 1.1.7 dhe nenit 15, paragrafi 3 të Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës; nenit 5, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës nr. 1003/2016; si dhe kërkesës nr. 140 së datë 11.07.2018, Qendra Klinike Universitare publikon:

KONKURS

Per: Një (1) Teknik për Riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocave invalidore, shtretërve të pacienteve dhe inventarit të punës.
Institucioni: Qendra Klinike Universitare e Kosovës
Departamenti: Sektori i Shërbimeve Teknike së QKUK-së,
Norma e punës: Orari i plotë,
Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
I Raporton: Udhëheqësit të mirëmbajtjes së rrjetit të ujit dhe kanalizimit
Kategoria funksionale/Grada 4.8
Nr. i Referencës: QKUK-28/2018-07/1

Qëllimi kryesor i vendit të punës për Teknik për Riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocave invalidore ,shtretërve të pacienteve dhe inventarit të punës

Të përdor dhe të mirëmbaj në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet
Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Është i obliguar që gjatë orarit të punës t’u përmbahet masave të mbrojtjes në punë, standardeve teknike për pajisjen që e ka në përdorim dhe udhëzimeve për punë për pajisjet të kësaj natyre.
 - Është i obliguar që gjatë orarit të punës të bashkëpunojë me personelin e klinikës dhe të plotësojë kërkesat e personelit të autorizuar mjekësor që kanë të bëjnë me përdorimin dhe të mirëmbajtjen në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet
 - Kontrollon pajisjen, gjendjen funksionale dhe paralajmëron me kohë udhëheqësin e drejtpërdrejtë
 - Është përgjegjës për pajisjen që e ka në disponim që ta kontrollojë, mirëmbajë dhe t’a mirë përdorë ashtu që padisja të jetë në gjendje funksionale dhe në gjendje gatishmërie për përdorim kurdo që është e nevojshme.
 - Të asistojë në hartimin e udhëzuesve të procedurave të shkruara mbi punën e serviserit.
 - Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit kur ajo është e nevojshme.
 - Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit ku punon.
 - Të ruajë kufidencialitetin të plotë për çështjet që kanë të bëjnë me punën e institucionit, përveç në rastet kur ajo/ai autorizohet me shkrim, në përputhje me politikën Institucionale.
 - Të regjistrohet dhe licensohet tek autoritetet përkatëse zyrtare.
 - Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin të lartë në punë.
- Njohuria, shkathtësitë dhe përvoja e kërkuar**
- Aftësi për përdorimin e pajisjes
 - Aftësi për njohjen e punës
 - Aftësi për evitimin e defekteve të çastit
 - Aftësi për riparimin dhe mirëmbajtjen e karrocave invalidore ,shtretërve të pacienteve dhe inventarit të punës .

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit :

1. Diplomë e Shkollës së Mesme,jo mjekësor
2. Të ketë shkathtësi për të krijuar marrëdhënie të mira ndërpersonale;
3. Aftësi për të ndihmuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët;
Certifikatën për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve
4. Certifikatën e lindjes,
5. Letërnjoftimi, fotokopje.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.
Originalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, bazuar në Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 kanë mbaruar shkollimin e duhur sipas këtij konkursi dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar për këtë pozitë.

Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QKUK. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Kontaktet me telefon mund t’i bëni në 038/500-600 25 15

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë të ofrojnë dëshmi sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

Çdo kandidat që aplikon dhe i plotëson kushtet sipas konkursit do t’i nënshtrohet testit më shkrim prej 100 poenëve. Kandidatet të cilët kalojnë 50 % të testit, fitojnë të drejtën të thirrën për intervistim me gojë.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University
Clinical Center of Kosovo
Sektor Osoblja



U skladu sa članom 8. stav 1. i 2. Zakona o radu br.03 / I-212, AI (MRSZ) No.07 / 2017 procedure za konkurencije u javnom sektoru; Član 6, podstav 1.1, član 10 Statuta bolničke službe i Univerzitetski klinički centar Kosova (SHSKUK); Član 13, stav 1, član 10, stav 1.1.7 i član 15, stav 3 Statuta Univerzitetskog kliničkog centra Kosova; Član 5, stavovi 1 i 2 Pravilnika o radnim odnosima br. 1003/2016; kao i navod br.140 od 11.07.2018. godine, Univerzitetski klinički Centar Kosova, objavljuje:

KONKURS

Za: jedan (1) tehničar za popravku i održavanje invalidskih kolica, pacijentovih kreveta i inventara rada.
Institucija: Univerzitetski klinički Centar Kosova
Sektor: Sektor tehničkih usluga UKCK,
Radna stopa: puni raspored,
Ugovor: Prema važećim zakonima
Izveštavam: Odgovornog održavanja mreže vode i otpadnih voda
Funkcionalna kategorija / Grad 4.8
Br. Referenca: UKCK-28 / 2018-07 / 1

Cilj glavnog radnog mesta za tehničku popravku i održavanje invalidskih kolica, pacijentovih kreveta i inventara rada
Koristite i održavajte svu opremu ispravno i sigurno
Glavne dužnosti i odgovornosti

- U toku radnog vremena dužan je da postupi u skladu sa zaštitnim merama na radu, tehničkim standardima za opremu u upotrebi i uputstvima za rad za takvu opremu.
- Obavezan je da u toku radnog vremena sarađuje sa osobljem klinike i ispunjava uslove ovlašćenog medicinskog osoblja koji se bavi upotrebom i pravilnim i bezbjednim održavanjem sve opreme
- Proverava opremu, funkcionalno stanje i blagovremeno upozorava lidera
- Odgovorna je za opremu koja je dostupna za kontrolu, održavanje i korišćenje, tako da je oprema u funkcionalnom stanju iu stanju pripravnosti za upotrebu kad god je to potrebno.
- • Pomoći u izradi pisanih procedura o radu servisa.
- Pohađati sastanke tima po potrebi.
- Sudjelovati u aktivnostima koje se organizuju u okviru programa za pojedine jedinice usmjeren na razmjenu znanja i informacija među osobljem koje radi.
- Održavati punu kofidencialitet o pitanjima koja se bave radom institucije, osim ako on / ona je dozvoljena u pisanom obliku, u skladu s institucionalnim politikom.
- Registrirati i licencirati relevantne službene organe.

- Izvršiti druge dužnosti koje zahtijeva nadzornik kako bi se osigurala visoka efikasnost na poslu.

Potrebno znanje, veštine i iskustvo

- Sposobnost upotrebe opreme
- Sposobnost prepoznavanja posla
- Sposobnost izbjegavanja trenutnih defekata
- Sposobnost popravke i održavanja invalidskih kolica, kreveta za pacijente i inventara rada.

Kvalifikacija, iskustvo, veštine i lične karakteristike, na osnovu specifičnosti ustanove:

1. Diploma srednje škole, a ne medicinska
2. imati veštine za uspostavljanje dobrih međuljudskih odnosa;
- 3 Sposobnost pomoći i saradnje sa drugima;
Potvrda o popravci i održavanju opreme
4. Izvod iz knjige rođenih,
5. Fotokopija, fotokopija.

Dokumentacija priložena ovoj aplikaciji se ne vraća.

Original ovih dokumenata ili atestiranih notara će biti potreban samo kada se kandidat pozove na posao.

Uslovima učešća u zapošljavanju: pravo da se odnosi na sve građane Republike Kosova odraslih koji imaju punu sposobnost da djeluje, na osnovu Administrativnog uputstva (MRSZ) No.07/2017 su završili odgovarajuće školovanje pod ovom takmičenju i imaju profesionalnu sposobnost za obavljanje zadataka.

Takmičarski postupci: Konkurs je otvoren za sve kandidate zainteresirane za ovu poziciju. Konkurs se objavljuje 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Prijavni zahtevi: Prijave su primljene i dostavljene u kancelariju UKCK kadrovske službe. Aplikacija treba jasno navesti naziv posla i referentni broj. Telefonski kontakti se mogu izvršiti na 038 / 500-600 25 15

Aplikacije poslate nakon završetka takmičenja i nepotpune zahteve neće biti prihvaćene.

Aplikanti pružaju dokaze koje je konkurs za različite kandidate koji ne ispunjavaju uslove konkursa neće biti pozvan na intervju.

Svaki kandidat koji se prijavljuje i ispunjava uslove pod takmičenjem biće predmet pisanog testa od 100 bodova. Kandidati koji polože 50% testa, zarađuju pravo da budu pozvani na usmeni razgovor.

Generalni Director UBKSK

Dr. Basri Sejdiu



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Divizioni për Komunikim me Publikun
Divizija za Javno Komuniciranje
Division of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë dhe therret e raportuara të gjedhit për tremujorin e parë (TM2) 2018

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të vazhdoj të mbështes sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër dhe therret e raportuara të gjedhit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit që aplikojnë për Pagesa Direkte – qumësht sipas kategorive të cilësisë:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të jenë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (personat juridik);
- Të jenë të regjistruar në sistemin e Identifikimit dhe të Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Ta kenë kontratën për shitjen e qumështit me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojë dëshmi të lëshuar nga laboratorit i AUV-së për cilësinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose pikën grumbulluese të qumështit, i pranueshëm për pagesë është qumështi i kategorive: Ekstra, Klasi i Parë dhe i Klasi i Dytë;
- T'i dorëzojë më së paku 1500 litra qumësht për 3 (tre) muaj (sipas tremujorëve të vitit kalendarik);
- Të ofrojë dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Të ofrojë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruajë për kompaninë;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit;
- Kopjen e listës së verifikimit të gjedheve të lëshuar nga sektori për Identifikim dhe Regjistrim (I&R) në kuadër të AUV-së;
- Kopjen e kontratës për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara në Kosovë ose nga pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë për sasinë e qumështit të dorëzuar sipas cilësisë, në qumështore ose në pikat grumbulluese të qumështit, të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara në Kosovë;
- Dëshminë nga banka për pagesën e bërë nga qumështorja për sasinë e dorëzuar;
- Dëshminë për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit”;
